

EDUART THARTORI

NJË DITË SA NJË MIJË VJET EDUART THARTORI

NJË DITË *sa* NJË MIJË VJET

Titulli:

Një ditë sa një mijë vjet

Autori: Mr. Eduart Thartori

Mentor: Prof.Dr.Hafiz Hajredin Hoxha

Redaktimi Gjuhësor: Jorida Çaç

Kopertina: Jorida Çaç

STAMBOLL

Turkiye

Libri Dhurohet falas për secilin.

PARATHËNIA E PROF.DR.HFZ. HAJREDIN HOXHA

Të gjitha falënderimet dhe lëvdatat i takojnë vetëm Allahut Fuqiplotë, Meshiruesit, Meshirëbërësit, Hakmarrësit, Të Drejtit, I cili krijoi jetën dhe vdekjen, krijoi çdo gjë me precizitet, urtësi dhe drejtesi. Krijoi qiejtë dhe tokën dhe tërë krijesat tjera me masë dhe qëllim të caktuar për një kohë, exhel të caktuar, për ta njohur Allahun xh.sh., për t'i besuar Atij dhe për t'iu nënshtruar urdhërit Tij. I dhuroj njeriut shpirtin, jetën dhe e krijoi në formën më të mirë për të parë se cili prej tyre garon dhe bën vepra më të mira dhe më të sinqerta. Falënderimi i takon Krijuesit, Plotëfuqishmit i Cili na urdhëroi dhe kërkoi nga ne implementimin e urdhërave të Tij, implementimin e Sheriatit Islam (kodit/ligjit akaidologjik, etik, familjar, social, ekonomik, politik), dhe e bëri këtë jetë kaluese dhe urë lidhese për në jetën tjetër, e që në gjuhën e Kur'anit ajo jetë quhet Ahiret, fazë tjetër të jetës së përjetshme, të vazhdueshme, me sistem dhe specifika tjera të jetës.

Salavatet dhe selamet, urimet, bekimet tona qofshin për krijesën më të bukur, zoteriun tonë, të dashurin e zemrave tona, zotëriun dhe vulën e pejgamberëve, përgëzuesin, qortuesin, paralajmëruesin, udhërefyesin tonë të mëshirshëm, Muhamedin a.s., paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi familjen e tij të pastër, shokët e tij fisnik, dhe për të gjithë ata besimtarë që ndoqën dhe akoma ndjekin rrugen e tij qartë, të sigurtë dhe të pastër. Allahu qoftë i kënaqur me ta, amin ja Rabel Alemin.

Lexues të dashur, Allahut ju mbuloftë me të mirat e Tij.. amin

Librin me titull: NJË DITË SA 1000 VJET, që keni në duart tuaja, pata nderin që të jem recensent, kontrollor, redaktor i kësaj vepre madhështore të vellaut, kolegut, edukatorit, autorit dhe hoxhës sonë të dashur Mr.Eduart Thartori, i cili me një mjeshtëri të madhe, me një oratori të veçantë, me një stil shkrimi të pa parë, me një ilustrim artistik shkencor fetar të matur dhe të argumentuar, fenomenal atraktiv dhe impresionues, që prek mendjen, shpirtin, gjymtyrët, intuitën dhe emocionet, prek zemrën dhe kokën, suksesshëm dhe me mjeshtëri profesionale na prezantoi, demonstroi bukurinë, madhështinë, ndodhitë e asaj jete të përjetshme të Ahiretit, të asaj boteje të amshueshme, të pavdekshme, me detaje dhe hollësira të rëndësishme të mirargumentuara me Kur'an dhe Hadith gjer në atë masë sa që bukuria narrative përshkruese e paraqitur në këtë punim madhështor të ngren lartë, të kaplon fizikisht dhe shpirtërisht, dhe ke dëshirë të flaktë për të vdekur në momentin ti kur lexon këtë libër, për t'i shijuar ato mirësi, ato kënaqësi, ato shpërblime, ato dhurata që nuk i kemi pa, që nuk kemi ndëgju për ta dhe as që mundemi me imagjinue për madhështinë, shijen, bukurinë e tyre të pregaditura nga Allahu xh.sh. për robërit e Tij besimtar musliman të denjë e të sinqertë... ma sha Allah, aferim, të lumtë i dashtuni hoxhë dhe edukator shpirtëror Eduart Thartori.

Të dashur lexues, Allahu ju begatoftë me të mirat e Tij, amin.

Sipas vizionit Kuranor dhe atij profetik, storia e njeriut kalon apo përjeton 5 faza të rëndësishme gjatë jetës së tij:

1- Faza shpirtërore e krijuar para fazës fizike trupore. Tërë shpirtërat njerëzore janë krijuar me një kohë dhe për një moment, dhe pasi që janë krijuar, Allahu, Krijuesi i tyre i ka pyetur: a jam Zoti, Krijuesi, Allahu i juaj? Ata u përgjigjen një zëri: PO, sigurisht, pa dyshim, Ti je Zoti, Krijuesi ynë, që do të thotë, të gjitha shpirtërat (njerëzit) janë krijuar

Musliman, dhe kur ata lindin, lindin me besim të pastër të Tevhidit, Musliman, jo Çifut, jo Krishter, jo Budist, jo Hindus, dhe më pas fëmija i lindur mer besimin e prindërve, të rrethit se ku jeton dhe ku edukohet. Ky realitet është dëshmuar në Kur' an në suren el E'raf, ajeti:172, *“Përkujto kur Zoti Yt nxori nga shhpina e bijve të Ademit pasardhësit e tyre dhe i bëri dëshmuar të vetes së tyre (duke u thënë): “A nuk jam Zoti juaj?” Ata thanë: “Po, dëshmuam!”- Allahu ju thotë- Të mos thoni në ditën e kijametit: “Ne nga ky (dëshmim) ishim të panjohur..”*. Ky realitet është transmetuar edhe në hadithe të sakta nga Muhamedi a.s., që çdo i lindur lind me natyrë të pastër, fe të pastër islame, musliman, më pastaj ai fëmij i lindur musliman, nëse prindërit janë me besim dhe ideologji tjetër ai e mer besimin e tyre, rritet dhe zhvillohet me ideologji të shtëpisë, institucionit, regjimit etj.

Caktimi, vullneti i Allahut Fuqiplotë ka dashtë që këto shpirtëra të krijuara herët të mos krijohen, lindin, të mos vijnë në këtë botë menjëherë, por me kohë dhe momente të caktuara, persona të caktuara, dhe së këndejmi gjer në ditën e fundit të kësaj procesi i lindjes dhe i vdekjes akoma vazhdon edhe sot kështu, disa lindin, disa të tjerë vdesin.

2- Faza e dytë, jeta ne barkun e nanës. Çdo njeri i gjallë sot është fakt konkret që ai e ka kaluar këtë fazë, e cila ka pas një sistem jete të caktuar dhe shumë specifike, me shumë etapa zhvilluese interesante të jetës së embrionit gjer në lindje. Aty në barkun e nanava tona kemi jetuar, 7, 8, 9 muaj, me të gjitha kushtet e jetës normale, por me një sistem tjetër, dhe këtë realitet askush nuk mund ta mohojë.

3-Faza e tretë, jeta jonë aktuale, jeta mbi këtë tokë ku gjindemi tani. Kjo jetë ka tjetër sistem të jetës që sot ne e dijme. Vullneti i Krijuesit tonë, Allahut Fuqiplotë ka dashtë që mesatarja e kësaj jete të jetë mes 60-70 vite, me përjashtime, plus minus. Në këtë jetë kemi ardhur me një qëllim, me ditë dhe afat të caktuar. Kjo është kaluese dhe se destinacioni i fundit nuk është këtu. Në këtë jetë kemi obligime reciproke ndaj njeri

tjetrit dhe të drejta legale ashtu si kanë udhëtarët transit nëpër aeroporte ndërkombëtare para se të shkojnë në destinacionin e fundit të tyre. Në këtë jetë duhet të sundojë, mbizotërojë ligji, sistemi i Sheriatit Islam, të cilin Allahu xh.sh., e shpalli dhe e qartësojë anën teorike në Kur'an detalisht, dhe se Muhamedi a.s., i dërguari i Tij e konkretizoj me punë dhe vepra. Natyra dhe karakteristika e kësaj jete është se ajo përmban sprovë, gëzime, hidhërime, sëmundje, vdekje, pasuri, vearfëri, luftë, masakra, gjenocid, fitore, padrejtësi, korrupsion, tirani, zullum, hipokrizi, tradhti etj etj, dhe se ne nuk po shohim drejtësi absolute për të cilin Allahu xh.sh. flet në librin e Tij. Tani shtrohet pyetja e madhe: Vallë, a do të vije ajo ditë ku ne do ta shohim drejtësinë e Allahut xh.sh, ? Në këtë jetë nuk pamë drejtësi as për kasapin e Ballkanit Millosheviçin dhe bashkëpunorëve tij Ratko Mladiç, Radovan Karaxhiç. Natanjahu kasapi izraelit çifut akoma po mbyt, po shkatërron, po bombardon, po copëton që 14 muaj që nga 7 Tetori 2023 gjer sot 20.12.2024, mbi 45.000 dëshmorë në Gaza, dy të tretat fëmijë dhe gra, mbi 107.244, të plagosur, mbi 7700 familje janë zhduk nga regjistri i librit të amzës. Administrata terroriste e Bajdenit, Blinkenit, dhe shtetet europiane aleate të kësaj masakre dhe të këtij gjenocidi, si Gjermania naziste, Britania kolonialiste raciste e shumë të tjerë ndihmëtarë, përkrahës numër 1 me armë, me bomba, me dronë, me tanke, për misionin e gjenocidit dhe të spastrimit etnik izraelit të paparë mbi vëllezërit tanë palestinezë në Gazën heroike muslimane dhe trime. Gjykata e Hagës për krime lufte 13 muaj nga frika nuk ishte në gjendje me lëshue flet arresti për kriminelët e luftës në Gaza. Shtrohet pyetja: vallë a ka Zot! Vallë ku është drejtësia në këtë jetë! Gjer kur do të vazhdojnë kështu këta kriminel çifut cionist?

Përgjigjja është në mbrendi të këtij libri që keni në duar. Patjetër drejtësia, hakmarrja, shpërblimi do të vije një ditë, e ajo ditë është dita e Ahiretit në botën tjetër, Xheneti ose Xhehenemi. Logjika e shëndoshë

e kërkon atë ditë, drejtësia absolute e kërkon atë ditë, prandaj ajo ditë është afër edhe pse ne e shohim ndoshta si të largët.

4- Faza e katërt, jeta në varr, në gjuhën e Kur'anit quhet jeta në el Berzakh, një ndarje, perde, barierë, periudhë kohore e gjatë gjer në ringjallje, nuk kemi argumente se sa zgjatë ajo periudhë. Thotë Allahu xh.sh. “ E kur ndonjërit prej tyre i vjen vdekja, ai thotë: “O Zoti im, më kthe, që të bëj vepra të mira e të kompensoj atë që lëshova!” *Kurrsesi, (Kthim nuk ka) e kjo është vetëm fjalë që thotë ai, e ata kanë para tyre një perde (distanca periodike) der në ditën kur ringjallen “*, el Mu'minune: 99-100. Një jetë shumë speciale në varr, me sistem special ne nuk jemi në gjendje për ta kuptuar. Ashtu sikurse nuk jemi në gjendje për ta kuptuar sistemin e jetës në barkun e nanës. Por ajo doli se ishte realitet. Askush nuk di se sa do të zgjasë jeta në varr, vetëm i Madhi Zot Allahu di se sa do të jetojmë në fazën e 4, në varr. Kur'ani dhe Syneti flasin për temat tjera që kanë të bëjnë me jetën në varr, por nuk flasin për gjatësinë e jetës në varr, jeta para Ahiretit.

5-Faza e pestë, ringjallja nga varri, për llogari, vend tubimi i të gjithëve në Mahsher, e pastaj kalimi mbi një urë speciale që është vendosur mbi Xhehenem për të kaluar në bregun tjetër të shpëtimit, ku një grup direkt shkon në Xhenet për veprat e mira, a ndërsa tjetri në Xhehenem për veprat e këqija. Këtu mbaron historiku i njerezisë, këtu mbaron historia e njeriut. Këto 5 faza të jetës janë faza që shumë pak prej nesh besimtarëve Musliman i ka parasysh, dhe së këndejmi ardhja e asaj dite tjetër, dita e llogarisë, dita e Ahiretit, e asaj bote të amshuemshme është drejtësi hyjnore, kërkesë logjike, kërkesë legale për ta pa drejtësinë e Fuqiplotit, Allahut Dhul Xhelal, se si hakmiret prej krimineleve dhe si i shpërblen të mirët e devotshmit.

Lexues të ndershëm,

Më lejoni tani të kalojmë në pikën e dytë të kësaj hyrje. Pse ky punim në këto momente të vështira të jetës sonë psiqike, etike, shpirtërore, ekonomike dhe politike ?

Prej emrave dhe cilësive të Allahut Fuqiptotë janë: I Drejti, Drejtësia, I Urti dhe Urtësia. Për ta demonstruar dimensionin e drejtësisë dhe të urtësisë në këtë gjithësi, në jetën sociale, Ai krijoi njeriun, ia dha mendjen, e bëri atë me përgjegjësi dhe vendosi peshoren, kriteriumin e objektivitetit dhe të drejtësisë. Ai e krijoi atë në formën më të përsosur dhe më të mirë, e pajisi me mendje të shëndoshë dhe e bëri halife, mëkëmbës të Tij në tokë. Kërkoi nga njeriu të besoj në revelatën Hyjnore të shpallur mbi pejgamberët, të dërguarit e Tij. Shpallja e fundit ishte Kur’ani Famëlartë, dhe i dërguari i fundit ishte Muhamedi a.s.. Allahu xh.sh. kërkoj nga ai ta praktikoj ligjin e Tij Kur’anin e Shenjtë të zbritur nga qielli, të cilin praktikisht me fjalë dhe me vepra e konkretizoi, ishte pra Kur’an i gjallë që ecte mbi fytyrë të tokës. I Gjithëmëshirshmi ynë kërkoi nga Muhamedi a.s., nga besimtarët Musliman ta përfillin Sheriatin Islam (ligjet, kodet, rregulloret, parimet, detalet e kushtetutës hyjnore për të mirën e njerëzisë pa dallim race dhe feje) në të gjitha sferat e jetës, rafshin akaidologjik, etik, familjar, social, ekonomik dhe atij politik. Ky sistem Hyjnor për ta parë dritën e implementimit kërkon një sundues, imam, halife, kryetar, kryeminister, mbret, emir, të sinqertë, të drejtë, trim, besimtar, i aftë, me një qeveri të pastër të sinqertë, jo të korruptuar për ta jetësuar ligjin e Allahut xh.sh. në të gjitha sferat e jetës sonë. Historia njerëzore dhe ajo islame antike dhe moderne na mëson që ky sistem i Sheriatit i shpallur nga Allahu xh.sh. është jetësuar, është impelentuar me sukses në kohën e Muhamedit a.s., pastaj 4 halifët e tij, më pas dinastia emevite, abasite, selxhukiane, osmane, etj, sa që ia kanë pa hajrin edhe jobesimtarët islam.

Mjerisht koha moderne aktuale në të cilën jemi duke jetuar ka sjellur shumë dëme dhe pesimizma në zemrat dhe jetën e besimtarëve islam. Kjo gjendje globale e përgjakur, e mjeruar e muslimanëve nga zullumi, agresioni, tirania, padrejtësia globale e fuqive të mëdha, e sidomos nga cinoistët fanatik Çifut dhe të Krishterë dhe disa aleatë të tyre arab e të tjerë, ka ndikuar negativisht në zemrat dhe bindjen e besimtarëve Musliman se vallë ky Kur'an i shpallur nga Allahu xh.sh, a është me të vërtetë fjalë e Allahut Fuqiplotë? Ku është ndihma e Allahut e xh.sh. për besimtarët Musliman? Ku është drejtësia e Allahut të Mëshirshëm? Kur do ta shohim hakmarrjen e Allahut prej zullumqareve cionist çifut ateist sekular?

Në përgjigje të këtyre pyetjeve dhe të tjerave të ngjashme me këto vjen ky libër mubarek, i bekuar për ti zbutur zemrat e Muslimanëve, për ti ledhatuar kokat e jetimave që kanë humbur prindërit e tyre, për t'i qetësuar dhimbjet e nanave që kanë humbur femijët dhe të dashurit e tyre, për t'u dhënë freski dhe durim grave veja që kanë humbur burrat e tyre në këtë masakër, gjenocid izraelit ndaj popullit palestinez në Gaza, dhe në vende tjera ku janë torturuar dhe torturohen muslimanët dhe të pafajshmit.

Lus Allahun Fuqiplotë me shpërblye autorin e kësaj vepre, lexuesin e kësaj vepre, të gjithë ata të cilët kontribuan në kompletimin, pregaditjen dhe botimin e saj, amin, amin, amin.

I juaji sinqerisht,

Shërbyesi i Kur'anit dhe Muslimanëve

Hfz.Hajredin Hoxha,

Doha-Katar, 21.12.2024

www.drhafezi.net

PARATHËNIA E AUTORIT

Ky punim që keni në duar është një punë e bërë me shumë dashuri dhe me përkushtim. Ka qenë një frymëzim prej Zotit, me e thënë të drejtën. Sa që kur iu ktheva librit për ta rishikuar, nuk më besohej që unë i kisha shkruar këto rreshta. Kjo është gjendja emocionale që e kaplon çdo njeri herë pas here dhe bën ato veprat më të zgjedhura të vetat. Dikush në literaturë, dikush në shkencë, dikush në arte vizuale. E imja ishte në përshkrimin e asaj Dite të Madhe.

Në fakt këtu gjej rastin të nxis edhe shumë kolegë të nderuar të fushave të ndryshme Islame, që të vazhdojnë edhe ata të shkruajnë veprat e veta. Le të mos mjaftohen më, vetëm me përkthime. Ka ardhur koha që edhe vetë të tregojmë atë dituri dhe përvojë që e kemi mbledhur për vite.

Libri që keni në duar, në fakt është një fidan që unë po e mbjell në zemrat e secilit prej jush. Dhe shpresoj që frytet e tij ti shoh në varrin tim dhe sigurisht në ditën e madhe të peshoreve.

Fillimisht Allahun e falenderoj që ma mundësoi ta shkruaj këtë libër dhe ta sjell në duart tuaja.

Një falenderim i posaçëm edhe për të gjithë ata që ndihmuan në perfeksionimin e këtij libri, profesor Dr. Hafiz Hajredin Hoxha i cili ishte një mentor thelbësor në shkrimin e këtij libri në mënyrën më të mirë akademike dhe sigurisht dhe atyre që ndihmuan në përgatitjen dhe botimin e këtij libri..

Libri është Dhuratë prej autorit për secilin prej jush. Është një fidan, frytet e të cilit shpresoj ti shikojmë në varrin tonë. Ditën kur të gjithë do të na lejnë të vetëm, pasi të kenë hedhur nga një grusht dhë mbi ne.

Me respekt

Mr. Eduart Thartori

PASQYRA E LËNDËS

- Parathënia e Dr. Hajredin Hoxhës.....f.
- Fjala e Autorit f.
- Një ditë sa njëmijë vjet f.
- Mahsherf.
- Çfarë po ndodh me fytyrat e njerëzve..... f.
- Dielli mbi Kokëf.
- Vetëm një Ditë..... f.
- Shefaat.....f.
- Paraqitja e Madhe.....f.
- Xhehenemi po sillet aty.....f.
- Xhehenemi është ndezurf.
- Vijnë Librat f.
- Hej Shikoni librin timf.
- Peshoretf.
- Gjykimi.....f.
- Dhe fillon gjykimi.....f.
- Ura e Siratitf.
- El E`arafëf.
- Në bregun e Shpëtimit.....f.
- Portat e Xhenetitf.
- Xhehenem.....f.

- Vdekja vdes.....f.
- Vetëm një Moment.....f.
- Hakmarrje e pamundur.....f.
- Zebanijet e Xhehenemit.....f.
- Koha e Ushqimit.....f.
- Shumë kohë më vonë.....f.
- Xheneti është zbukuruar.....f.
- Hapen dyert e Xhenetit.....f.
- Xheneti është krejt diçka tjetër.....f.
- Burimi i Keutheritf.
- Akomodimet në Banesat e Përherhshme.....f.
- Elita e njerëzimit.f.
- Pamje Perfekte dhe Rini e Përherhshme.....f.
- Banesat e Xhenetlinjve.....f.
- Huritë e Xhenetitf.
- Plakat rikthehen në moshën e Dashurisë.....f.
- Shëtitje.....f.
- A nuk do të velitemi nga kjo Kënaqësi.....f.
- Jetë Sociale.....f.
- Pazari i Xhenetit.....f.
- Dëshira të Veçanta.....f.
- Historia.....f.
- Dashuria.....f.
- Lumenjtë dhe Liqenet.....f.
- Rrobat e Xhenetlinjve.....f.
- Disa kujtime të vështira.f.
- Njeriu i fundit në Xhenet.....f.
- Është dhe dikush atje.....f.
- Hapet Perdja e Allahutf.

KAPITULLI I PARË

NJË DITË SA NJË MIJË VJET

Dita e Kijametit, sipas Kuranit dhe Haditheve të Pejgamberit a.s

(A nuk mendojnë ata se do të ringjallen, në një Ditë të madhe? Ditën, kur të gjithë njerëzit do të dalin para Zotit të botëve)¹

MAHSHER..²

Vendi i Tubimit të përgjithshëm..

(Kur do t'i fryhet Surit, do të vdesin të gjithë ata që gjenden në qiej dhe në Tokë, përveç atyre që do Allahu; pastaj do të fryhet për të dytën herë në Sur³ dhe ata përnjëherë do të ngjallen e do të presin.)⁴

(..varret po trazohen)⁵

(.. Po nxjerr barrën nga brendia e saj. E njeriu të thotë: “Ç’po i ndodh asaj?!”

Atë Ditë ajo do të tregojë lajmet e saj, sepse Zoti yt e ka frymëzuar atë.

¹ Kurani, Sure Mutaifin ajetet 4-6

² Vendi se ku do të tubohen krijesat.

³ Briri në formë borie, që engjëlli Israfil i fryn në shenjë sinjali për të nisur ngjarjet e mëdha. Fryn herën e parë për të nisur Kijameti dhe herën e dytë, për të nisur Ringjallja..

⁴ Kurani, Sure El Zumer, Ajeti 68.

⁵ Kurani, Sure El Infitar, Ajeti 4.

Atë Ditë njerëzit do të paraqiten grupe-grupe, që t'u tregohen veprat e tyre)⁶

Po dalim të gjithë nga varri. Të gjithë po habiten. Madje edhe besimtarët po habiten.

Ata i kanë besuar të gjitha, çfarë Zoti u tha për këtë ditë. Por nuk e kishin provuar këtë, live. Nuk e kishin provuar sesi është të dalësh nga dheu, e të pastrosh trupin prej dheut. Nuk e kishin provuar sesi është të formohet përsëri trupi që ke patur. Pasi ka qenë tretur për shekuj me rradhë, në dhé.

Dal unë, del edhe ti, edhe ai tjetri. Shpejt gjithë ajo fushë e madhe mbushet me njerëz, që sapo kanë mbirë nga dheu. Ti dhe unë jemi njëri nga miliarda e miliarda qenie njerëzore, që sapo kanë mbirë nga toka. Tamam si ato fijet e grurit. Imagjinoni, pasi e ke hedhur farën në tokë, farërat nisin të çajnë dheun. Ky proces në bujqësi zgjat me javë. Nga koha kur toka është e kaftë, e deri kur prej saj dalin fije-fije filizat e parë të grurit. Derisa krejt toka të bëhet e blertë.

Aty pranë teje do të dalë edhe bashkëshortja jote, pak më tej edhe fëmijët edhe prindërit. Por ata duket sikur nuk kanë asnjë lidhje me ty. Secili habitet me veten e tij. Nuk po të njohin. Pret t'i takosh. Por secili është i zënë me hallet e veta.

(Atë ditë njeriu do të largohet nga vëllai i tij. Nga nëna dhe babai i tij, nga gruaja dhe fëmijët e tij. Atë ditë secili do të ketë hallet e veta)⁷

⁶ Kurani, Sure El Zelzele, Ajetet 1-6

⁷ Kurani. Sure Abese, Ajeti 34.

Pastaj sheh se ajo masë e madhe të ringjallurish, kanë marrë një drejtim. Pa vetëdije të gjithë ecin. Ecin drejt fushës së madhe të Mahsherit. Vendit ku grumbullohen të gjithë.

(Dhe, do të fryhet në Sur, e ata do të dalin nga varret dhe nxitojnë kah Zoti i tyre, duke thënë: “Mjerë për ne! kush na ngjalli prej Varreve tane, ku preheshim?” (U thuhet): “Ja, kjo është ajo që e ka premtuar Mëshiruesi, e Pejgamberët e kanë thënë të vërtetën!”)⁸

Disa njerëz ecin duke u habitur, për trupin e tyre. Shohin sesi në gjymtyrët e tyre ka dritë. Ajo buron nga vetë mishi i tyre. Nga fytyra e tyre. Është vendi ku u prekte uji i Abdesit përditë. Sot ai Abdes po ua ndriçon fytyrën.⁹

ÇFARË PO NDODH ME FYTYRAT E NJERËZVE?

(Atë ditë do të ketë fytyra të ndriçuara, të qeshura e të gëzuara)¹⁰

Janë besimtarët. Ata që e besuan Allahun, pa e parë. E besuan Pejgamberin a.s, edhe pse kishte shekuj që ai ishte larguar nga jeta. Ata përsëri i besuan, pavarësisht sprovave të dynjasë. Premtimet të Allahut, ata i besuan. Sa herë që e gjithë bota ishte kundër, ata me bindje të

⁸ Kurani, Sure Ya-sin, Ajetet 51-52

⁹ Bazuar ne Hadithin e transmetuar tek Muslimi me numër 249 Dhe ja sesi e përshkruan Pejgamberi a.s këtë moment: [Do doja të shikoja vëllezërit tanë. -Sahabet i thanë: A nuk jemi ne vëllezërit e tu? Pejgamberi a.s thotë: Ju jeni Sahabet e mi. Vëllezërit tanë janë ata që nuk kanë ardhur akoma. -Shokët përsëri e pyetën: Po si do t'i njohësh ata, o Pejgamber i Zotit? Pejgamberi a.s i tha: E keni parasysh kur dikush ka një kalë me një pullë të bardhë në ballin e tij. E njeh kalin e tij mes shumë kuajsh të tjerë? Ashtu edhe ata do të vijnë me fytyra të ndritura nga Abdesi. Unë do ti mbledh ata në Liqenin tim, dhe aty nuk do të vijë askush përveç tyre.] Hadith i Saktë

¹⁰ Kurani, Sure Abese. Ajeti 38-39

palëkundur thanë: E megjithatë Premtimi i Allahut është i vërtetë. Ata sot buzëqeshin, janë të lumtur. Ka dalë ashtu si e besonin ata.

Nga ana tjetër, sheh disa njerëz me fytyra të errëta, janë në hall të madh. E kuptojnë se kjo ditë është e tmerrshme për ta. Disa të tjerë qajnë me të madhe, duke thënë: Ah, na e patën thënë Pejgamberët, por nuk ua besuam...

(Kurse disa fytyra, atë ditë do të jenë të pluhrosura. Do t'i mbulojë terri i fortë. E ata janë mosbesimtarët e mbrapshtë.)¹¹

Tashmë të gjithë jemi në një fushë të madhe. Edhe unë edhe ti. Edhe ai apo ajo, që ecnin me eskortë dhe që e shikoje vetëm në televizor. Sot nuk ka më VIP-a. Të gjithë do të jenë aty. Po po, aty dhe të gjithë lakuriq. Si herën e parë kur lindën. Nuk ka më tituj, nuk ka më doktorë shkencash dhe as shkëlqesi. Të gjithë janë aty, duke pritur çfarë do të ndodhë me ta. Askush nuk di asgjë. Askush nuk mund të thotë diçka. Janë të gjithë lakuriq, burra dhe gra. Por askush nuk e ka mendjen të shohë tjetrin. Të gjithë kanë hallet e veta.

Disa janë të qetë, disa janë të tmerruar. Disa kokën e mbajnë ulur me frikë. Disa i kthejnë sytë lart nga qielli.

DIELLI MBI KOKË..

Papritur skena ndriçohet. Dielli po afrohet mbi kokat e njerëzve. Aty janë me miliarda njerëz, të gjithë duke vuajtur në nxehtësinë e tij. Fillon djersa të kullojë dhe nuk po flasim për ballin e lagur. Por nga djersa e tyre, nis të bëhet baltë në këmbët e tyre. Pastaj pak nga pak po bëhet pellg me ujë. Pastaj uji ngrihet më shumë, derisa nisin të notojnë në ndjersën e tyre. Disa gati sa nuk mbyten me djersët e tyre. Skena tmerri,

¹¹ Kurani, Sure Abese. Ajeti 40-42,

frike, trishtimi, sikur të një anijeje të mbytur, ku mijëra njerëz mundohen të notojnë për mbijetesë..¹²

Gjithsesi është vetëm fillimi dhe kjo është vërtetë shumë pak. Nga ajo që i pret ata..

VETËM NJË DITË

Do të jetë vetëm një ditë. Por jo një ditë si gjithë ditët e tjera. Ajo është një ditë që llogaritet sa 1000 vjet me ditët e kësaj bote.

(Vetëm një ditë tek Zoti, është sa njëmijë vjet sipas llogarisë suaj.)¹³

Aq sa njerëzit dëshpërohen në pritje, lodhen, frikësohen për çfarë i pret. Ata, akoma nuk e kanë parë zjarrin. Disa kanë nisur të bëjnë llogaritë. Sa qëndruam në atë botë? Pyesin njëri-tjetrin. Disa thonë një ditë të vetme, si kjo.

(“Po sa vjet keni kaluar në tokë?” Ata thonë: “Kemi qëndruar një dite, ose një pjesë të ditës)¹⁴

Janë gjeneratat që kanë jetuar në këtë botë, disa shekuj me rradhë. Disa thonë: vetëm një pjesë të kësaj dite. Disa madje do të thonë se gjithçka kaluam në atë jetë, ishin thjesht disa orë. Janë ata që jetuan më pak. Imagjinoni 70 vitet e jetës sonë në një ditë sa 1000 vjet tonat.

Të gjitha për çka luftuam dhe harxhuam jetën tonë, ishin vetëm për disa çaste që shijuam. E gjitha, a ia vlejti?

¹² Bazuar në Hadithin e saktë tek Buhariu: [..Dielli do të afrohet ditën e Kijametit, derisa djersët do të arrijnë në nivelin e gjysmës së veshëve..] Hadithi me numër 1475

¹³ Kurani, Sure El Haxh, Ajeti 47

¹⁴ Kurani, Sure El Muminune, Ajetet 112-113

Aty në atë fushë të madhe të Mahsherit, disa prej njerëzve do të jenë të qetë. Do të jenë në hijen e Arshit të Allahut.

Ndërkohë që pjesa tjetër do të jenë duke u munduar nën tmerrin e diellit mbi kryet e tyre.

Këta do të jenë në një vend të lartë, të freskët. Ata janë të zgjedhurit e Allahut të Madhëruar. Për ta nuk do të ketë mundime të tilla. Janë ata njerëz, që ishin dashuruar me Xhaminë. Ata që duheshin me njëri tjetrin, për hatrin e Allahut. Janë ata që refuzuan tundimet dhe jetuan një jetë të ndershme. E shumë të tjerë që vetëm Allahu i njeh dhe i ka zgjedhur, për atë ditë, të jenë nën hijen e Arshit të Vet. Për ta Pejgamberi a.s thotë: *[Shtatë kategori njerëzish, Allahu do ti fusë në Hijen e Arshit të Tij, ditën kur nuk do të ketë asnjë vend në hije, veç nën Arshin e Tij. Një lider i drejtë. Një djalosh që është rritur me adhurimin e Zotit. Një burrë që e përmend Allahun në vetminë e tij dhe i shkojnë lotë nga sytë (prej dashurisë që ka për Allahun). Një burrë që e ka zemrën e lidhur me Xhaminë. Dy miq, që u deshën vetëm për Hatrin e Allahut. Një burrë që e tundon një grua e pasur dhe e bukur. Por ky e refuzon duke i thënë: Kam frikë Allahun. Një tjetër burrë, që jep Sadaka të fshehtë. Aq sa nuk ia sheh dora e majtë, çfarë po jep dora e djathtë.]*¹⁵

SHEFAAT..¹⁶

¹⁵ Hadithi transmetohet nga Buhariu, duke u konsideruar i Saktë.

¹⁶ Ndërmjetësimi në Ditën e Gjykimit. Do të bëhet nga Pejgamberi a.s, por jo vetëm. Për besimtarin, do të ndërmjetësojnë Engjëjt, do të ndërmjetësojë Kurani, do të ndërmjetësojnë punët e tij të mira që ka bërë.

Do të qëndrojmë të gjithë aty, duke pritur. Nga mundimi i madh i pritjes, njerëzit do qajnë derisa lotët ti shterojnë. Të gjithë duan vetëm diçka. Gjykimi të fillojë.

Madje edhe zullumqarët që e dijnë se nuk kanë shpëtim, duan të nisë gjykimi sa më shpejt. Të gjithë duan vetëm të mbarojë kjo fazë. Le të shkojnë në Zjarr, vetëm nga aty të largohen. Por ajo fazë nuk mbaron.

Njerëzit shkojnë tek Ademi a.s, njeriu i parë dhe i kërkojnë atij të ndërmjetësojë tek Zoti, që ta nisë gjykimin. Por ai refuzon për shkak të gjynahut të tij. Shkojnë pastaj tek Nuhu, tek Ibrahim, tek Musai dhe tek Isai a.s, por të gjithë refuzojnë. Por të gjithë kanë frikë. Deri kur shkojnë tek i dashuri i Allahut, Muhamedi a.s. Ai e merr përsipër dhe shkon i vetëm para Arshit të Allahut. Aty ai bie në Sexhde dhe qëndron ashtu pa lëvizur.

Allahu i mëson atij disa Lutje dhe Madhërime për Allahun, që ai nuk i ka ditur fare në këtë botë. Janë fjalët që i takojnë atij vendi në të cilin ndodhet. Pejgamberi a.s është ngritur në atë që quhet “Mekam Mahmud” Pozita e Nderuar..

Pastaj Allahu me Madhështinë e Tij, i flet: O Muhamed!

Ndërsa Muhamedi a.s përgjigjet: Po!

Allahu i thotë: Ngrije kokën, kërko dhe do të të jepet!

Pejgamberi a.s thotë: Më ke premtuar që do të ndërmjetësoj për njerëzimin. Të lutem Allah, nise Gjykimin e Njerëzimit.

Allahu thotë: Prano het prej teje. Do ta nis Gjykimin e Njerëzimit.

Kjo është “Pozita e Nderuar” tha Pejgamberi a.s.¹⁷

¹⁷ Paragrafi i sjellë këtu, është në fakt përmbledhje e disa hadithesh të saktë. Ku Pejgamberi a.s i kërkon Allahut të Madhëruar, që të nisë Gjykimin. Në disa transmetime të tjera Pejgamberi a.s i

PARAQITJA E MADHE..¹⁸

(Para Zotit tënd, po sillen në rresht. “Na keni ardhur ashtu siç ju kemi krijuar herën e parë. Ju menduat se nuk do të kishim takim përsëri”)¹⁹

Pastaj diçka tjetër e madhe ndodh. Sot në fakt është dita kur ndodhin gjërat e mëdha.

Një oshëtimë e madhe dëgjohet dhe qielli nis të hapet..

(Është dita kur po fryhet në Sur dhe ju po vini turma-turma. Dhe qielli po hapet.. E bëhet dyer dyer..)²⁰

Hapet qielli i parë dhe krejt engjëjt zbresin aty dallgë-dallgë të rreshtuar. Pastaj hapet edhe qielli i dytë dhe prej atje zbresin engjëjt dallgë-dallgë. Po kështu edhe nga qielli i tretë dhe i katërti, i pesti dhe i gjashti dhe i shtati. Engjëjt rreshtohen në rreshta gjigande, pritet një shfaqje e madhe. Pritet të shfaqet në Horizont, Allahu me madhësinë e Vet.

(Dhe kur vjen Zoti yt, e engjëjt qëndrojnë rradhë-rradhë!)²¹

Krejt njerëzimi që gjendet aty bashkë me xhindet, kur shohin këtë fenomen, u kërkohet të bien në sexhde. Dhe ata nisin të bien në sexhde. Njerëz dhe xhinde, besimtarë dhe pabesimtarë, të mirë dhe të këqinj. Të gjithë bien në sexhde. Allahu i madhëruar është paraqitur. Mirpo kush nuk e njohu çfarë është sexhdeja në këtë botë, në atë moment, nuk do të mundet të përkulet në sexhde. I mjeri, do të dojë dhe ai të bëjë sexhde.

kërkon Allahut të ndërmjetësojë për Umetin e tij, etj.. Ndër këto Hadithe është edhe ai i shënuar tek Buhariu me numër 6565.

¹⁸ Është fjala për Daljen para Allahut, pas ringjalljes nga varri.

¹⁹ Kurani, Sure El Kehf, Ajeti 48.

²⁰ Kurani, Sure En Nebe`, Ajeti 18-19.

²¹ Kurani, Sure El Fexhr. Ajeti 22

Por trupi nuk do t'i përgjigjet. Shtylla kurrizore është bllokuar në një kockë të vetme. Atëherë, ai i mjerë hidhet përmbys, veç ta bëjë atë sexhde.

(Ditën e vështirë, kur zbulohen të gjitha dhe do të thirren që të përulen në sexhde. Por nuk do të munden)²²

XHEHENEMI PO SILLET ATY..

Në shtatëdhjetë mijë vegja të mbajtura. Po vjen ajo “Gjëja”. Është ajo “gjëja” që e ka emrin Xhehenem. Në çdo vegjë, janë shtatëdhjetë mijë engjëj, që e ngrejnë atë peshë.²³

XHEHENEMI ËSHTË NDEZUR..

Ky krater gjigand që është afruar në Mahsher, është aq i thellë, sa për të rënë në flakët e tij, nga maja ku është vendosur Ura e Siratit, duhen shtatëdhjet vjet rënie e lirë. Ai turfullon, zjarri aty është i errët. Nxehtësia e tmerrshme e djeg edhe dritën. Asgjë aty nuk i ngjan zjarrit që njohim. Pejgamberi a.s thotë se vetëm një pikë zjarri i Xhehenemit të hidhet mbi këtë botë, do ta mbushte krejt atmosferën tonë me erë të qelbur dhe do ta bënte jetën të pamundur këtu.

(Po paraqitet Xhehenemi për zullumqarët..)²⁴

Tashmë Xhehenemi është gati të pranojë banorët e tij. Por akoma nuk janë bërë gati banorët e tij, për të hyrë aty. E kujt ia mban ta shohë atë vend? Mirpo vetëm zhurma e tmerrshme e tij, ka futur

²² Kurani, Sure El Kalem, Ajeti 42

²³ Bazuar në hadithin e saktë, të transmetuar nga Muslimi me numër 2842. [Xhehenemi do të sillet me 70 mijë vegja. Në çdo vegjë mbahet nga 70 mijë engjëj].

²⁴ Kurani, Sure El Shuara, Ajeti 91.

panik të madh në Mahsher. Vaj, e lotë. Lutje me aman o Zot, mos më hidh në Xhehenem. Ah sa shumë njerëzit do luten në ato momente.

*(Kur t'u tregohet prej së largu, do ta dëgjojnë si ushton dhe tërbueshëm vlon.)*²⁵

KAPITULLI I DYTË

VIJNË LIBRAT..

Një fenomen i habitshëm po ndodh. Një turmë e madhe zogjsh, që po vjen drejt tyre. Po vijnë shpejt dhe po ulen mbi ta. Nuk qenkan zogj, por qenkan libra. Disave libri u vjen lehtë dhe butësisht në anën e djathtë dhe ata e presin. Është i ndriçuar. Ata e shfletojnë dhe lumturohen. Është libri i veprave të tyre.

²⁵ Kurani, Sure El Furkan, Ajeti 12

Sot nuk ka nevojë të të thonë të tjerët. Vetë do t'i shohësh notat e tua..

(Lexoje librin tënd, sot të mjafton ta llogaritësh vetë vetveten!)²⁶

E shohin të habitur. Shumë kapituj aty kanë marrë notën: I FALUR.. I FALUR.. I FALUR.. Janë mëkatet e tyre, që janë falur. Disa kapituj, kanë marrë notën SHKËLQYESHËM.. I PRANUAR.. MIRNJOHJE.. Janë të mirat që bënë. Agjërimet, Namazet, Sadakatë dhe fjalët e mira që thanë. Janë aty të vërtetat që mbrojtën me gjakun e tyre. Janë aty edhe vitet e burgut që bënë, padrejtësisht. Janë aty edhe lotët e nënave që humbën fëmijët e tyre. Janë aty edhe kamxhikët që provuan në rrugë të Zotit. Janë aty edhe përbuzjet që provuan, se ishin besimtarë; sepse mbanin shaminë, apo se mbanin mjekërr.

(HEJ SHIKONI LIBRIN TIM)

Thërrasin të lumturuar.

(Kujt t'i jepet libri i vet nga e djathta e tij, ai do të thotë: Hej! Ja, lexojeni librin tim!)²⁷

Por ka edhe të tjerë që nuk janë si ata. Atyre libri u ka ardhur në krahun e majtë. Libri i tyre është i errët. Kanë frikë ta hapin. Kushedi sa e sa maskarallëqe ka aty. A thua do të jenë shënuar të gjitha?

(Edhe libri u jepet dhe do të shohësh mëkatarët të frikësuar për shkak të asaj që gjenden në të. Dhe do të thonë: “Të mjerët ne, çfarë është ky libër? Nuk i ka shpëtuar as mëkati i madh as mëkati i vogël,

²⁶ Kurani Sure El Isra` Ajeti 14

²⁷ Kurani Sure El Hakka, Ajeti 19

të tëra janë evidentuar”. Do ta gjejnë të shkruar atë çka e kanë bërë. Zoti yt askujt nuk do t’i bëjë padrejtësi.)²⁸

(Kurse ai të cilit libri i jipet në dorë të majtë, do të thotë: “O i mjeri unë, të mos më jepej fare libri im. Të mos e dija fare se si është përfundimi im. Ah, sikur të kishte qenë ajo (vdekja e parë), mbarim i amshueshëm për mua. Pasuria ime nuk më bëri fare dobi. U hoq prej meje çdo kompetencë imja.)²⁹

Nisin ta shfletojnë. Ato janë aty të gjitha. Koha kur ka vrarë një zog të vogël pa mëshirë, atëherë kur ishte akoma një djalë i ri. Koha kur ia nxiu jetën gruas, nënës së fëmijëve të tij. Koha kur vinte netëve i alkolizuar. Koha kur e rrihte gruan dhe fëmijët, thjesht sepse nuk i kishin plotësuar tekat e tij..

Koha kur u bë financier banke dhe vodhi shumë para. Ai tjetri po sheh sesi janë shënuar vendimet gjyqësore, që ai ka marrë kur ishte gjykatës. Po sheh, sesi e futi në burg atë fukaranë, thjesht se i duhej një njeri në burg, për të shpëtuar atë politikanin që vërtetë i kishte bërë ato krime.

Edhe ai qafiri që thoshte se Zoti nuk ekziston, edhe ai po e shfleton librin e tij. Kush pra, kush ma solli këtë libër? Kush më ringjalli? Kush më solli këtu? Ah i mjeri unë, të kisha bësuar, atëherë kur të gjithë njerëzit besuan.

Por sot nuk e di nga tia mbajë. Fillon të shikojë shiritin e jetës së vet. Të gjitha horrlëqet që ka bërë, tradhëtitë, dallaveret, vjedhjet, kamatën etj. Sa shumë që është lodhur për t’i fituar ato para të shkreta. Po sot ku janë? Si ka mundësi që të jem mashtruar kaq keq? A ia vlejti tani? Gjithë ajo garë e madhe për tu bërë deputet, për të hyrë në qeveri,

²⁸ Kurani Sure El Kehf, Ajeti 49

²⁹ Kurani, Sure El Hakka, Ajetet 25-28.

për ti patur krejt në dorë. Gjithë mashtrimet, premtimet, stërkëmbëshat, korrupsioni..etj. A ia vlejti sot? Sot është koha e shpagimit. Sot nuk ka as gjykata, dhe as pushtet që të mbrohet. Të gjithë kanë hallet e veta.

(Atë Ditë zullumqari do t'i hajë gishtat e duarve të veta, e do të thotë: "Ah! Sikur ta kisha marrë rrugën me Pejgamberin! Ah! Sikur të mos e kisha bërë filanin mik! Ai, më ka penguar nga udhëzimi që më erdhi!". Djalli, e braktis gjithmonë njeriun në poshtërim.)³⁰

Por më keq, do ta kenë disa të tjerë. Ata që me dijen e tyre u shërbyen zullumqarëve.

Ata që justifikonin zullumet e tyre, duke manipuluar ajetet e Kuranit. Ata që justifikonin zullumqarët me bindje të plotë. E për çfarë? Për karrigen e ngrohtë të Rektorit të Universitetit; apo të kryetarit të Komunitetit; apo ndoshta edhe për një zarf të mbushur me para?

Dje llogaria ishte: Më mirë me zullumqarin, sesa kundër zullumqarit. Por sot? Ku do ta gjejë shefin e tij Zullumqar?

Nuk është shumë larg tij në fakt. Diku më tej, duke vajtuar për hallet e veta. Por ai e përze atë, si një klysh qeni. Duke i thënë: Më ler rehat se kam hallet e mia.

Disa të tjerë, akoma po presin. I dijnë krimet e veta dhe nuk shpresojnë asgjë të mirë. Duart i kanë pas shpinës se nuk duan ta marrin fare atë libër. Por Libri nuk gabon të zotin e vet. Librat e tyre të poshtërsive, u përplasen mbi shpinë.

(Ndërsa, atij që do t'i jepet libri i tij pas shpinës. Do të mallkojë veten)³¹

³⁰ Kurani, Sure El Furkan, Ajeti 27-29

³¹ Kurani Sure El Inshikak, Ajeti 9-10

Nuk shpëtojnë dot. Edhe ata do ta marrin librin e tyre. Por çfarë të lexojnë? Ai ishte prokurori që ka dënua me vdekje dhjetëra burra dhe gra të pafajshëm. Ai ka ndarë nënën nga fëmija. Ai ka bërë genocid mbi njerëz të pambrojtur. Madje ai kënaqej kur shikonte krijesën e gjallë të vuante prej tij. Sot është koha e shpagimit dhe ai e di mirë këtë.

PESHORET..³²

Pas një kohe të gjatë pritje, më në fund vjen koha e së vërtetës. Gjithçka bëme, e çfarë sakrifikuam, e çfarë vepruam, do të peshohen sot. Këtu në Mahsher po vendosen Peshoret..

(Në ditën e gjykimit, Ne do të vëmë peshore të drejta. Askujt nuk i bëhet e padrejtë asgjë, edhe nëse është ajo, sa pesha e një kokrrë të melit, do ta sjellim atë, aty. E mjafton që Ne jemi Llogaritës.)³³

Ndërkohë që peshoret vendosen, diçka tjetër po ndodh aty në fushën e madhe të Mahsherit. Disa njerëz po zgjidhen mes të tjerëve. Engjëjt janë futur në turmat e njerëzve dhe po tërheqin zvarrë ata që kanë qenë më barbarët. Tmerri ka filluar.. Të gjithë janë në panik. Kënd mund ta kapin kthetrat e tmerrshme të engjëjve të Xhehenemit. Mund ta kapin atë që ishte pranë teje. E sheh sesi qan i lemerisur. Kapen për zverku e për koke, për këmbësh e për trupi.. Emrin e kanë Engjëj, por nuk janë dhe aq të bukur. Ata janë engjëj të Xhehenemit dhe mund t'i quash me meritë Bishat.. Sepse nuk njohin mëshirë. Nuk janë krijuar për të mëshiruar. Janë krijuar për të torturuar, për të masakruar.. Janë Zebanijet e Xhehenemit.

³² Nga vetë titulli bëhet fjalë për një njësi matëse. Por që kjo e ditës së Gjykimit do të jetë ndryshe. Do të masë gjithçka, gjëra materiale dhe ato kuptimore. Dhe matja do jetë tmerrësisht e saktë.

³³ Kurani, Sure Enbija, Ajeti 47

(Është dita kur do të shohin Engjëjt. Nuk ka asgjë të mirë atë ditë, për kriminelët. U thuhet heshtni! Pushoni!)³⁴

(Kriminelët njihen me tiparet e tyre, e kapen rrëmbyeshëm për koke dhe për këmbësh)³⁵

Janë ata, më kriminelët, që vranë dhe shfarosën njerëz të pafajshëm. Diktatorët, Spiunët, Servilët, shtypësit e popujve të vet. Tradhëtarët, ata që për një fjalë që ia thanë armikut, shkaktuan genocid mbi popujt e pafajshëm.

Të gjitha ata, tani po merren. Po zgjidhen aty mes turmave, aty ku ndodhen. Nuk kanë si fshihen. Engjëjt i dijnë ata, i njohin. Shkojnë direkt tek ata. Engjëjt kanë listën gati dhe dijnë kënd ta marrin.

Ata nuk do të gjykohen fare. Nuk do ta kenë atë nder, që të paktën të dëgjohen çfarë kanë për të thënë. Jo, ata thjesht do merren zvarrë. Do të grumbullohen të gjithë në një vend. Aty engjëj të tjerë do t'i bëjnë ata si një lëmsh të madh mishrash njerëzore dhe frymëra xhindesh.

Të gjitha bashkë këto specie barbare, në një lëmsh të madh. Ashtu si janë, do të hidhen në zjarr të Xhehenemit, menjëherë. Nuk ka asgjë që e ndalon. Nuk përfillen lutjet e tyre dhe as “aman-et” e tyre.

Pasi ata u morën.. Tani rradhën e kanë disa ushtri të tjera me Engjëj që po vijnë. Janë Engjëjt e Xhenetit. Janë shumë të bukur, vezullojnë nga shkëlqimi i tyre. Edhe ata kanë për detyrë të marrin ca njerëz. Po ulen me kujdes. Ata zgjasin duart e tyre dhe ngrejne disa njerëz të tjerë. Kësaj rradhe ata vijnë me respekt dhe me dashuri.

(Po sillen në grupe, për në Xhenet, ata që ishin të devotshëm ndaj Zotit të vet. E kur vijnë aty, u hapen dyert e tij. E u thonë, rojtarët

³⁴ Kurani, Sure El Furkan, Ajeti 22

³⁵ Kurani, Sure El Rrahman, Ajeti 41

e Xhenetit: Paqja qoftë me ju. Ishit të mirë. Andaj futuni aty përjetësisht)³⁶

Janë ata.. Janë ata që hyjnë në Xhenet pa llogari fare. Janë të privilegjuarit e Zotit.

Shtatëdhjetë mijë veta, dhe pas çdo njërit prej tyre edhe shtatëdhjetë mijë të tjerë, po ngrihen lart. Ata nuk do të merren në llogari fare.³⁷

Janë Amnistuar. Allahu ata i ka privilegjuar, nuk don që ata të mundohen këtë ditë.

Po kush janë ata fatlumë?

Ata janë Pejgamberët (a.s) janë Dëshmorët dhe njerëzit e Sinqertë. Janë ata që në këtë botë u quajtën budallenj. Janë ata që në këtë botë përbuzeshin dhe i quanin, njerëz të trashë, që nuk dijnë të gënjejnë dhe ta dredhin si shumica e bën. Ata sot u morën dhe po nderohen. Bashkë me ta edhe familjarët e tyre. E pra sot është koha që ata ta gjejnë premtimin e Zotit, për të gjitha vuajtjet e tyre. Për qëndresën e tyre në të drejtë.

GJYKIMI..

Asnjë gojë nuk do të flasë. Asnjë njeri, xhind, apo engjëll, nuk ka leje të flasë. Vendin e kaplon një heshtje e madhe. Të gjithë janë në ankth. Allahu, Mbreti i ditës së Gjykimit, kështu ka vendosur. Askush nuk pipëtin. As Engjëjt, as xhindët dhe as njerëzit, madje as kafshët. Heshtje totale..

³⁶ Kurani, Sure Ez Zumer, Ajeti 73

³⁷ Bazuar në Hadithin tek Buhariu me numër 6472, ku Pejgamberi a.s thotë: *[Nga Umeti im do të hyjnë në Xhenet 70 mijë persona, pa llogari fare.]*

(Kjo është dita kur nuk flet askush, Madje as për t'u shpjeguar)³⁸

Si, edhe kafshët? Po, po, edhe kafshët janë ringjallur. Edhe ato janë aty, në ditën e gjykimit.

Aq detaje ka kjo punë sa do të vihet drejtësia deri edhe me kafshët. Pejgamberi a.s thotë: *[Çdo hak do të kthehet tek i zoti, në ditë të Kijametit. Derisa edhe delja shytë do të marrë hakun e saj nga delja me brirë]*³⁹

Por ndryshe nga njerëzit dhe xhindet, kafshët pas gjykimit, do të shpërbëhen duke u bërë thjesht dhë. Pejgamberi a.s ka thënë: *[Allahu do të mbledhë krejt krijesat, kafshët, shpendët, dhe njerëzit. Pastaj në fund, kafshëve do tu thotë: Bëhuni dhë! Atëherë pabesimtari do të thotë: Ah i mjeri unë, sikur të bëhesha edhe unë dhë!]*⁴⁰

Fillon gjykimi. Peshorja ka dy anë. Njëra është për veprat e mira dhe tjetra për veprat e këqija. Të gjitha do futen aty. Do të jetë e çuditshme ajo peshore. Aty në krahun e majtë, të punëve të këqija, do të hyjnë edhe disa vepra të mira.

Ne na dukeshin se filani e kishte bërë të mirë, atë vepër. Por ku ta dinim ne, se ai nuk e ka patur me sinqeritet? Madje edhe engjëlli që e ka shkruar, e ka shkruar si punë të mirë. Por Allahu nuk e vlerëson të tillë. Sepse nuk e ka dhënë atë sadaka, për hatrin e Allahut. Por e ka dhënë që të thuhej se ky është bujar i madh.

³⁸ Kurani, Sure El Murselatë, Ajetet 35-36

³⁹ Hadithi është i Saktë dhe gjendet në Përmbledhjen e Muslimit me numër 2582

⁴⁰ Hadith i saktësuar nga Shejh Albani dhe i shënuar në Përmbledhjen e Haditheve të Sakta.. Vol 4/607

Edhe shumë dituri që dijetari ka shpërndarë, po këtë fat do të kenë. Nuk futen në anën e djathtë të peshores. Sepse nuk e ka patur për hatrin e Allahut. Por për të fituar postin e kryetarit.

Madje aty do të hyjë edhe gjaku i dëshmorit. Po, mor po. Edhe disa dëshmorë do dalin huq, atë ditë. Sepse nuk luftuan për hatrin e Allahut.⁴¹ Por luftuan për Partinë, për idealet komuniste, apo fashiste. Mbrojtja e Atdheut, nuk është justifikim. Sepse këtu nuk ka më Atdhe. Asnjë vepër që nuk ka qenë për hatrin e Zotit, nuk mund të futet në anën e djathtë të Peshores.

Do të shohim aty edhe disa njerëz që i nderonim shumë. Ishin disa dijetarë me çallma të mëdha. Sa herë kemi ëndërruar të bëhemi si ata. More për ta jemi jemi zënë me njerëzit, duke i mbrojtur. Ata flisnin gjithmonë fjalë të mira dhe ndalonin nga të këqijat.

Por sot këta janë aty dhe do të dënohen. Njerëzit habiten me ta. Si është e mundur që do të dënohen? Por ata do ta shpjegojnë veten e vet. -Ah, ne ju thoshim ju mos e bëni këtë, por vetë e bënim. E kur ju nxisnim për vepra të mira, vetë nuk i zbatonim.⁴²

Do ketë prej tyre që peshorja e anës së djathtë do të peshojë shumë. Por kur të vendoset ajo fjala, me të cilën tradhëtoi Besimin e Allahut, të gjitha të mirat e tij bëhen pluhur.

Do të vijë edhe shumë humanistë. Ndoshta do të kenë shumë vepra humanitare që kanë bërë. Por të gjitha shkojnë bosh. Sepse nuk janë bërë për Allahun, që është Zoti dhe Mbreti i kësaj dite. Nuk janë bërë për këtë gjykatë, sot. Ato janë bërë për zota të tjerë, që sot janë zhdukur. Zota që sot janë vetë aty, duke u gjykuar.

⁴¹ Bazuar në Hadithin e saktë tek Buhariu, me numër 3126

⁴² Bazuar në Hadithin e saktë, tek Muslimi me numër 2989

Sot njerëzit do të kërkojnë për ndonjë të mirë të tyre, ku të kenë mundësi të mbledhin sa më shumë. Sepse peshorja duhet të mbushet. Nëse jo, Xhehenemi është aty, duke turfulluar. Nuk ka shpëtim. E vetmja rrugë është mbushja e peshores me vepra të mira.

(Atyre që do tu rëndojnë peshoret (e të mirave), ata janë të shpëtuarit)⁴³

Disa do të jenë me fat. Sepse në këtë botë, janë përgojuar shumë. Andaj do të merren nga përgojuesit dhe do tu jepet këtyre që u përgojuan. Disa të tjerë do të marrin ca të mira, nga malli që i është vjedhur në këtë jetë.

Dikujt iu rrëmbye pa të drejtë toka, dikujt pensioni, dikujt pasuria. Sot hajdutët do të dorëzojnë çfarë kanë vjedhur. Eh sa me fat që janë. Ku ka ditë më të mirë për të rikthyer hakun e vet? Sot më shumë se kurrë u duheshin ato.

Dikush do të jetë i dështuar komplet. Ka bërë shumë të mira. Por ka bërë edhe shumë të këqija. Ka ofenduar, ka përgojuar, ka vjedhur, ka dhunuar. Të gjitha viktimat e tij, tashmë po marrin prej tij, edhe ato pak të mira që ka bërë. Kur të mos ketë më për të dhënë, viktimat e tij, do të shkarkojnë tek ai gjynahet e tyre. Kështu ai do mbytet në gjynahe, edhe pse ka bërë shumë të mira.⁴⁴

Disa të tjerë nuk po e mbushin dot peshoren e vet, andaj shkojnë tek nëna, apo babai i vet. I kërkojnë atyre. Por ata janë keq për vete. - Shko more andej, i thonë, se kam hallet e mia. Po kështu do të thotë edhe gruaja, që ndanë të njëjtin shtrat bashkë. Sot nuk i bie mendja askujt. Kanë hallet e veta. Të gjithë thonë: Kam hallet e mia!

⁴³ Kurani, Sure El Mu`minune, Ajeti 102

⁴⁴ Bazuar në Hadithin e Saktë, që gjendet tek Muslimi me numër 2581

(Ditën kur do tia mbathë njeriu, prej vëllait të vet; prej nënës dhe babait; prej bashkëshortes dhe fëmijëve. Çdo njeri, atë ditë ka hallin e vet)⁴⁵

Në ato Peshore jo gjithçka vlen. Mendojnë disa se janë në këtë botë, ku burgun e tyre, mund ta bëjnë disa të tjerë. Mendojnë se për të shpëtuar kokën, kanë mundësi të sakrifikojnë njerëzit e tyre. Dikush ofron gruan e tij. I lutet Zotit duke thënë: Merre atë dhe më ler mua. Disa të tjerë thonë: Merrni fëmijët e mi, e më lini mua. Por Peshoret e Zotit, nuk janë si peshoret e dynjasë. Aty askush nuk shpague për tjetrin. Nuk mundet dikush tia hedhë paq, duke ia mveshur zullumet e veta, dikujt të pafajshmi. Jooo. Nuk shkon aty, ashtu.

(Krimineli dëshiron sikur të kishte paguar dënimin e asaj dite me bijtë e vet; me gruan e vet dhe me vëllain e vet; ose me të afërmit e tij, që ishin mbështetje e tij. More me krejt çka ka në tokë, e vetëm të shpëtojë! Por jo, kurrsesi, ajo është Ledhdha - Xhehenem)⁴⁶.

Nga ana tjetër..

Çdo fjalë e mirë që ke thënë në jetën e dynjasë, do të ketë vlerë të madhe, në këtë ditë. Ka shumë njerëz që do të shpëtojnë vetëm prej një fjale të mirë, që i thanë një ditë një njeriu të dëshpëruar. Ata nuk e dijnë, por dikujt ajo fjalë i ka shpëtuar jetën. Por, pikërisht një fjalë mund të të shkatërrojë të gjitha të mirat që i ke bërë. Thënë dikur, pa ndonjë rëndësi të madhe prej teje. Por ajo ka bërë dëm të madh. Një sekret familjar ke zbuluar. Një akuzë, thënë ashtu kot, për nderin e dikujt. Sot ajo të shkatërron të gjitha punët e mira që ke bërë.

Pejgamberi jonë i dashur thotë: *[Njeriu mund të thotë një fjalë të mirë, pa i kushtuar shumë rëndësi. Allahu mund ta ngrejë me të, shumë*

⁴⁵ Kurani, Sure Abese, Ajeti 34-37

⁴⁶ Kurani, Sure El Mearixh, Ajetet 11-15

grada të larta. Ndërkohë që dikush tjetër flet një fjalë të keqe, pa i kushtuar asnjë rëndësi dhe me të hidhet në Xhehenem.]]⁴⁷

DHE FILLON GJYKIMI..!

Gjyqi, funksionon në mënyrë të përkryer. Thirren dëshmitarët. Por ata nuk janë si dëshmitarët e kësaj bote. Janë më realistë. Aty dëshmi të rreme nuk ka. Vetë duart do të dëshmojnë se e kanë kryer atë veprim të keq. Vetë syri do të flasë, e do të tregojë se e ka parë. Vetë këmbët e njeriut do të dëshmojnë se kanë shkuar. Atje nuk flet më goja. Por flet trupi yt, që i ka bërë ato të mira, ose ato të këqija.

(Sot Ne ua mbyllim gojën e tyre. Do të na flasin duart e tyre, dhe këmbët do të dëshmojnë.)⁴⁸

Pastaj është koha e ndërmjetësimeve. Po, po, atje ka ndërmjetësues.

Ai është Pejgamberi a.s, i cili vazhdimisht i lutet Allahut, për Umetin e vet që po merren në llogari. Atje janë edhe Engjëjt që po luten për besimtarët, që Allahu t'i mëshirojë. Atje janë edhe Kurani, Agjërimi, Sadakaja, Gjaku i dëshmorit, Pluhuri i tokës së betejës.

Të gjitha do të dëshmojnë dhe do të ndërmjetësojnë, që Allahu ta falë robin besimtar. Aty dëshmojnë edhe hekurat e birucës, edhe kamzhiku i xhelatit, që ka torturuar besimtarin. Të gjitha ato, do të kërkojnë falje për këtë njeri që ka vuajtur në rrugë të Allahut.

Është e tmerrshme gjithçka që po ndodh. Por për besimtarët ka shpresë.

⁴⁷ Hadith i Saktë i transmetuar tek Buhariu, me nr. 6478

⁴⁸ Kurani, Sure Ja-sin, Ajeti 65

Allahu ka premtuar se Mëshira e Tij do të jetë e madhe atë ditë. Nga 100 pjesë që e ka ndarë mëshirën e Tij, 99 prej tyre i ka rezervuar për këtë ditë.

Po, është e vërtetë askush nuk mund të shpëtojë në këtë gjykim, me Drejtësinë e Allahut. Nëse do të shpëtojmë, kjo do të ndodhë vetëm prej mëshirës së Allahut.⁴⁹

E megjithatë ka dhe prej tyre që nuk janë të bindur në këto fjalë. Njëri prej tyre, kërkon të shpëtojë me Drejtësinë e Allahut. Pasi mendon, se ai ka bërë shumë punë të mira dhe mund t'ia hedhë vetë këtij gjykimi.

-Jo, thotë Allahu, vetëm me Mëshirën Time do të shpëtosh. Por ky, akoma nuk është i bindur. Atëherë Allahu jep urdhër t'ia paraqiten të gjitha veprat e mira që ka bërë. Vërtetë që janë shumë. Pastaj nga ana tjetër e peshores, Allahu urdhëron të sjellin vetëm një nga shumë mirësitë që i ka dhënë robit të Vet. Mirësinë e Shikimit. A do të mjaftojnë krejt ato vepra të mira, për të falenderuar Zotin, vetëm për këtë mirësi të shikimit që i ka dhuruar?

Në Peshore kur vendosen, Shikimi peshon më shumë. E veprat e mira fluturojnë krejt. Atëherë robi bindet, se nuk mund të kalojë pa mëshirën e Allahut. Pastaj thërret me të madhe: Veç me mëshirën Tënde o Allah! Veç me mëshirën Tënde o Allah!

E vetëm kështu mund të shpëtojë..

Miliarda njerëz dhe Xhinde tashmë kanë mbaruar punë me gjykimin. Secili tashmë e di rrugën e vet. Disa për në Xhenet dhe disa

⁴⁹ Bazuar në Hadithin e saktë të Pejgamberit a.s përcjellë nga Ebu Hurejra. Transmetuar në Përmbledhjen e Haditheve të Sakta të Shejh Shuajb al Arnauti, me numër 7479

për në Xhehenem. Por akoma ka shpresë. Sepse përpara është Ura e Siratit..

Kur gjithçka ka mbaruar në gjykim, njëri doli nga peshoret, i falimentuar. Ai e di se, nuk ka shpëtim për të. Sepse në të gjitha ato vepra që kishte, vetëm një të mirë i kishte rezultuar. Por çfarë mund të bëjë ajo e mirë, para shumë të këqijave që i janë palosur në anën e majtë? Kështu i mjeri njeri, shpresëfikur, sheh ndonjë fatkeq tjetër që tia dhurojë atë të mirë që ka. Të paktën dikush të shpëtojë. Dhe e gjen vërtetë dikënd. Ai ishte baraz, të mirat dhe të këqijat ishin njësoj. Ishte i hutuar dhe nuk dinte nga të shkonte. Ka shpresë për Xhenet dhe për falje prej Zotit. Por gjynahet që kish bërë e mbanin peng.

(Përkundrazi, kush bën keq dhe e keqja e mbulon atë. Ata do të jenë banorë të zjarrit. Do të jenë aty, përherë)⁵⁰

Derisa vjen ky fatkeqi i parë. –Hej filan, merre këtë Sevap, i thotë. Shpëto ti të paktën se mua nuk më duhet më. Ndërsa ti mund të shpëtosh me këtë. Tjetrit i çelet fytyra nga lumturia. Shpresa iu kthye se mund të shpëtojë. Ato momente diçka e madhe ndodh.

Allahu i Madhëruar i flet robit të Tij, që i dhuroi Sevapin tjetrit: Hej Robi im, kjo që bërë është Bujari e mirë prej teje. Por ti nuk je kurrësesi më bujar se Unë. Andaj ti dhe ai tjetri të dy jeni të falur prej Meje dhe të dy do të shkoni në Xhenet..

Do të ketë aty edhe mënyra të tjera shpëtimi nga Xhehenemi.

(Kush shpëton prej Xhehenemit, do të futet në Xhenet. Ai është shpëtimi i vërtetë)⁵¹.

⁵⁰ Kurani, Sure El Bekare, Ajeti 81

⁵¹ Kurani, Sure El Imran, Ajeti 185

Disa shehida, që Allahu i ka graduar me nder të madh në gradën e Dëshmorit, sot është dita juaj, i thotë Allahu. Zgjidhni shtatëdhjetë familjarë dhe njerëz që doni nga ata që kanë mbetur në llogari. Ky është nderim i madh për ta.

Sot ata kanë leje të marrin për dore, prindërit e vet; gratë dhe fëmijët e vet; dajat e xhaxhallarët, e krejt ata njerëz që i kanë dashur në këtë botë. Kushti i vetëm është që të kenë qenë besimtarë dhe vdekur si besimtarë. Pasi për pabesimtarët nuk ka asnjë ndërmjetësim.

Pastaj Allahu i jep leje fëmijëve të vegjël që kanë vdekur në vegjëli. Sot ata janë të rritur, dhe vrapojnë tek prindërit e tyre në llogari. I marrin ata për dore dhe i tërheqin edhe ata në Xhenet.

Disa të tjerë do t'i marrin në Xhenet, Sadakatë e tyre. Kanë ushqyer të varfër, kanë mjekuar të sëmurë. Kanë shpëtuar jetë..

Tashmë njerëzimi ka mbaruar përfundimisht punë në peshore. Një grup bëhet gati për Xhenet.

Një grup nuk është aspak gati për tu hedhur në Xhehenem. E kush mund të jetë gati për tu hedhur në Xhehenem? Por gjithsesi janë aty dhe po presin rradhën kur zebanijet e Xhehenemit ta marrin.

Ka dhe një grup tjetër që dolën barazim. As në Xhenet, as në Xhehenem. Është një vend aty pranë që quhet Arafë. Është vendi asnjanes, ku ata do të qëndrojnë. Deri kur të merret vendimi përfundimtar për ta.

Mirpo për të gjithë, rruga kalon mbi Urën e SIRATIT.

Të gjithë pa përjashtim, të mirë e të këqinj, atje mbi të do kalojnë. Ose kalojnë me sukses, në anën tjetër. Ose për të rënë poshtë në Xhehenem..

Akoma asgjë nuk ka mbaruar për krijesat..

KAPITULLI I TRETË

URA E SIRATIT⁵²

⁵² Një urë e hollë vendosur mbi Xhehenem ku do të kalojnë të gjithë njerëzimi

Është koha e zbarkimit në Urën e SIRATIT. Kjo është sfida e fundit për Njerëzimin. Ose kalohet dhe shkon në Xhenet. Ose rrëzohesh dhe bie në Xhehenem.

(Çdokush prej jush, do të kalojë mbi të. Është vendosur tashmë prej Zotit tënd)⁵³

Dhe fillon kalimi në Urë.

Njerëzimi në fakt nuk ka rrugë tjetër. Tamam ashtu si kopeja e deleve që shtyhet pas nga barinjte. Ndoshta po ashtu turmat njerëzore, do të shtyhen nga Engjëjt.

(Pabesimtarët do të sillen në turma, për në Xhehenem,)

Të gjithë do të nisemi për të kaluar urën e Siratit. Mirpo jo të gjithë do ta kalojnë njësoj.

Ajo është një rrugë e hollë, shumë e hollë që kalohet duke mbajtur ekuilibrin mbi të. Poshtë saj është Krateri i Madh i Xhehenemit dhe rënia aty është e tmerrshme. Një rënie për 70 vjet. Derisa të preket fillimi i zjarrit të Xhehenemit.

Do të ketë prej tyre, që do të fluturojnë mbi urën e Siratit. Nuk do të shohin asnjë mundim me sy. Pastaj do të ulen në bregun tjetër, ku gjenden portat e mëdha të Xhenetit. Prej tyre janë Pejgamberët e Allahut, janë Dëshmorët dhe besimtarët e Singertë, (Evlijatë).

Pastaj do të ketë të tjerë që do të kalojnë të mbajtur nga Engjëjt. Ama do ta kalojnë. Do të ketë edhe prej tyre që do të mundohen shumë për ta kaluar. Rrëzohen dhe ngrihen përsëri, e përsëri rrëzohen, e përsëri ngrihen. U dhimbset shpirti. Nuk ka rrugë tjetër, sot duhet me çdo kusht të shpëtojë.

⁵³ Kurani, Sure Merjem, Ajeti 71

Por disa nuk do të kenë fat. Në ecjen e tyre mbi Sirat, ata do të rrëshqasin dhe do të bien në gjendje të lirë. Disa të tjerë do të ecin deri në një farë distance. Por gjynahet e tyre, që i kanë mbi shpinë, ua rëndojnë qafën. Tashmë ata duhet të mbajnë barrën e gjynaheve mbi shpinë dhe ekuilibrin e trupit mbi Sirat. Si për të mos u mjaftuar me këtë, disa ganxha dalin nga poshtë urës dhe i shqyejnë nga këmbët, ata që kalojnë mbi të.

Nga ana tjetër e urës, Pejgamberi Muhamed a.s dhe të gjithë Pejgamberët e tjerë qëndrojnë në pritje për Umetin e vet. Secili i lutet Allahut që të shpëtojë sa më shumë, prej ndjekësve të tyre.

Kush e kapërcen atë Urë, ka shpëtuar vërtetë. Për të nuk do të ketë më asnjë vështirësi. Ndërsa kush do të dështojë, për të, vuajtjet e vërteta sapo kanë filluar. Të gjithë e panë veten e tyre në peshore. Ata që dështuan e dijnë se nuk kanë për të shpëtuar. Mirpo ankthi dhe frika është edhe tek ata që panë peshoret e tyre të anojnë nga e mira. Kur të shohin atë urë të hollë, tepër të rrezikshme. Kur të shohin aty poshtë Xhehenemin, nuk ka tmerr më të madh që kanë parë më parë. I luten Zotit t'i forcojë për ta kaluar. E megjithatë, frika ekziston.

El E'RAFË⁵⁴

Në këtë skenë të tmerrshme fatesh njerëzore, mbushur plot frikë dhe lotë, do të ketë dhe një vend tjetër që do të jetë në mes. Është Zona e ARAFËS. Aty do të mblidhen të gjithë ata njerëz që peshorja e veprave të tyre ka qenë e barabartë. Janë ata që nuk janë cilësuar ende se ku do të shkojnë.

⁵⁴ Është një vend asnjanes. As në Xhenet as në Xhehenem. Aty do të mbahen ata njerëz që në peshimin e veprave të tyre kanë dalur të barabartë. Allahu do të vendosë për ta.

Këta shohin skenat e tmerrit dhe sesi shumë njerëz po bien në Xhehenem. Shohin poshtë dhe tmerrohen. E lusin Allahun që të mos i hedhë atje. Ndërkohë shohin lart sesi disa njerëz të tjerë, arritën ta kalojnë Siratin. Sesi ata gëzohen atje lart pranë portave të Xhenetit. Takohen me njerëzit e tyre të dashur, Pejgamberët dhe besimtarët dhe familjarët e tyre. Për ta është koha e shpërblimit.

Kur shohin poshtë, njerëzit që janë në Arafë, e lusin Allahun t'i ruajë nga zjarri i Xhehenemit. E kur shohin lart e lusin Allahun ti bashkojë edhe ata me njerëzit që do të hyjnë në Xhenet.

(Mes tyre është një ndarës. Atje në Arafë, janë disa njerëz që i njohin secilin me tiparet e tyre. U thonë banorëve të Xhenetit: Paqja qoftë me ju. Ata nuk kanë hyrë aty, por shumë e lakmojnë. E kur sytë e tyre kthehen nga banorët e Xhehenemit, thonë: O Zoti ynë, mos na bëj bashkë njerëzit zullumqarë.

Pastaj ata njerëzit e Arafës, dallojnë ca njerëz që i njohnin më parë dhe i thërrasin: ..Nuk ju bëri dobi sot, as pushteti që kishit dhe as fodullëku juaj. Këta (atje lart) që ju betoheshit se Allahu nuk ka për ti mëshiruar këta.. Sot atyre u thuhet: Hyni në Xhenet. Nuk do të ketë më frikë për ju, dhe nuk do të dëshpëroheni kurrë.)⁵⁵

NË BREGUN E SHPËTIMIT..

Pak nga pak, disa me shumë vështirësi, disa pa e parë fare, besimtarët e vërtetë, e kanë kaluar Urën e Siratit.

Tashmë gjenden aty në bregun e shpëtimit. Atje një grup i madh prej tyre po mbledhet secili rreth Pejgamberit të vet. Aty do të jenë pasuesit e Ibrahimit a.s. Do të jenë pasuesit e Musait a.s, rreth tij. Do të

⁵⁵ Kurani, Sure El E`arafë, Ajeti 46-49

jenë pasuesit e Isait a.s rreth tij. Pastaj do të jenë ata, më të shumtët në numër, pasuesit e Muhamedit a.s. Umeti i fundit musliman që erdhi në racën njerëzore. Ata që janë Umeti më i mirë, sepse ata gjithmonë nxisnin për të mirë dhe ndalonin nga e keqja. Allahu i quajti ata Muslimanë.

Tani është koha e ceremonisë së futjes në Xhenet. I pari që ka nderin të shkojë për të hapur portën e Xhenetit, është Muhamedi a.s. Mirpo befas aty, shkon një grua dhe dëshiron që ta hapë ajo portën përpara. Muhamedi a.s e pyet se kush ishte ajo që e donte këtë nder Ajo i thotë se në atë botën që lamë pas, kish qenë një grua besimtare e vejë, e cila pasi i vdiq burri, i rriti fëmijët e saj me nder dhe me hallall.⁵⁶

KAPITULLI I KATËRT

PORTAT E XHENETIT..

⁵⁶ Bazuar në një hadith të dobët të transmetuar nga Ebu Hurejra, në "It`haf el Heyra el Mehira ne vol 5/f.487

Xheneti i ka tetë porta. Ku sipas përshkrimit që Pejgamberi a.s i ka bërë këtyre portave, gjerësia e njërës prej tyre është sa distanca ndërmjet qytetit të Mekës dhe qytetit të Busras, në Siri. Një distancë prej 1300 kilometrash përafërsisht. Janë tetë porta të Xhenetit dhe secila do të fusë në të disa kategori të caktuara njerëzish.

1. PORTA IHLAS. Porta e Singëritetit me Allahun. Këtu do të hyjnë ata njerëz që shquheshin për singëritet me Allahun dhe për vepra që i bënë vetëm për hatrin e Tij. Ajo është një portë e vendosur në anën e djathtë të Xhenetit. Nga aty do të hyjnë fillimisht 70 mijë njerëz, pa asnjë llogari fare. Do të jenë prej atyre që kurrë nuk bënë dallavere, nuk vodhën e nuk çnderuan. Gjithmonë ata i mbështeteshin Allahut në hallet e tyre.
2. PORTA REJAN. Kjo është porta e agjëruësve. Atyre që shquheshin për agjërim të shumta, dhe që e kishin dashuri të madhe agjërimin. Kjo portë është posaçërisht vetëm për agjëruësit. Pasi të futen të gjithë ata, ajo mbyllet.
3. PORTA E NAMAZIT. Këtu do të futen të gjithë namazlinjtë që kurrë nuk e neglizhonin namazin e tyre. Madje e përjetonin atë me shumë kënaqësi. Shquheshin për korrektesë në namazet e tyre.
4. PORTA E XHIHADIT. Këtu do të hyjnë ata që luftuan në rrugë të Allahut, një pjesë ranë Shehida. Një pjesë tjetër i qëndruan deri në fund rrugës së tyre. Derisa ndërruan jetë si muxhahida.
5. PORTA E SADAKASË. Këtu do të futen të gjithë ata besimtarë që jepnin shumë sadaka. Ushqenin të uriturit, shpëtonin borxhlinjtë, ndërtonin vepra në dobi të njerëzve. Ndërtonin xhami, shkolla, parqe, pemë frutore. Madje ndihmonin edhe kafshët me sadakatë e tyre.
6. PORTA E RESPEKTIT TË PRINDËRVE. Kjo është aty posaçërisht për ata fëmijë të mbarë, që i mbajtën dhe nderuan prindërit, deri në fund.

Ata që fituan bekimet e prindërve, pavarësisht vështirësive që patën në shërbimin ndaj tyre.

7. PORTA “LA HAVLE VE LA KUVVETE ILA BI LAH” Kjo është një portë që do të hyjnë në të ata njerëz që vazhdimisht e thonë këtë fjalë. Duke qenë se ajo është kaq e rëndësishme për atë që e kupton. Ajo do të thotë: Nuk ka fuqi për të ndryshuar asgjë, dhe as energji tjetër, veç asaj që vjen prej Allahut. Kështu besimtari i ka mbështetur të gjitha forcat e tij, madje edhe shkaqet që i duhet të marrë, në forcën që ia kërkon Allahut. Me pak fjalë është i dorëzuar plotësisht Allahut të Madhëruar.

8. PORTA E HAXHIT. Aty hyjnë të gjithë ata që kanë bërë Haxhin me bindje dhe devocion të plotë dhe ai Haxh i është pranuar nga Allahu i Madhëruar.

Në çdo portë ka engjëj që po përgatiten ta hapin atë. Hyrja në Xhenet do të bëhet me ceremoni. Sepse në fakt ajo është suksesi i vërtetë dhe nderimi i vërtetë.

XHEHENEM..

Ndërsa nga ana tjetër atje poshtë ka dhe aty një shesh, ku janë mbledhur të gjithë banorët e Xhehenemit. Edhe ata pritët të futen në Portat e Xhehenemit. Aty në Xhehenem janë shtatë porta. Mirpo ato nuk janë si portat e Xhenetit që janë të vendosura horizontalisht. Portat e Xhehenemit janë në shtatë nivele, nën njëra tjetrën.

Niveli i Parë: HAVIJE⁵⁷ (Humnera). Xhehenemi fillon me një Humnerë të madhe.. Dhe është vetëm fillimi.. Është ai vend që për nga thellësia, nuk i duket fundi i saj. Allahu thotë në Kuran: **(Atyre që**

⁵⁷ Humnerë, në Xhehenem

peshoret e të mirës i kanë bosh, e kanë vendin në Humnerë. Por çfarë është Humnera? (Aty) Është zjarri që djeg tmerrësisht)⁵⁸ Ai do të jetë niveli i parë i banorëve të zjarrit. Do të ketë shumë prej tyre që do të qëndrojnë vetëm në atë nivel. Por do të ketë të tjerë që do të vazhdojnë të zhyten, nëpër nivelet e tjera.

Niveli i Dytë: LEDHA⁵⁹

Është Ledhi i zjarrit me flakë gjigande, tepër të forta. Aty në atë zjarr do të futen tradhëtarët. Ata që tradhëtuan amanetin. Ata që u zbrapsën nga rruga e vërtetë. Ata që në këtë botë, për shkak të interesave të tyre materiale, tradhëtuan vlerat dhe miqtë e tyre. Të gjithë ata do të futen në këtë vend. Allahu thotë në Kuran: **(Ajo është LEDHA. Që të heq skalpin e kokës, prej tmerrit të saj. Tërheq aty, ata që u zbrapsën dhe tradhëtuan.)**⁶⁰..

Niveli i tretë: HUTAME⁶¹.

Është niveli ku do të ngecin njerëzit kopracë dhe mendjemëdhenj. Ata që nuk besuan në këtë botë. Por jo vetëm kaq. Ata edhe i shtypën besimtarët me pasurinë e tyre. Ata që e kishin bollëkun, dhe e linin fqinjin e tyre të vdesë urie. Madje edhe ata padronë që ia rripnin lëkurën punëtorëve të tyre, duke i maltretuar dhe shfrytëzuar maksimalisht. Duke ia marrë djersën e ballit dhe duke mos i dhënë hakun. Këta zullumqarë të poshtër, do të hidhen sot në Hutame. Eh, Allahu na e shpjegon çfarë është Hutame. **(Mjerë për njerëzit që tallen dhe përgojnë. Mjerë për ata që kujdesen të mbledhin vetëm për veten e vet dhe numërojnë. Mendon se pasuria e tij do ta shpëtojë. Por kurrsesi jo! Do të hidhet i poshtëruar në Hutame. E ku e din ti çfarë është Hutame? Është zjarri i Allahut i ndezur fort. Që depërton deri**

⁵⁸ Kurani, Sure El Kariah, Ajetet 8-11

⁵⁹ Ledhi i Zjarrit me Flakë të forta

⁶⁰ Kurani, Sure El Mearixh, Ajetet 15-18

⁶¹ Shkatërruesi..

në thelbin e zemrës. Aty do ti pllakosë ata dhe do tua zërë frymën. Në shtylla të gjata flakëruese)⁶²

Niveli i Katërt: XHEHIM⁶³. Në këtë nivel zjarri është diçka tjetër. Është kulmi i tragjedisë, për atë që e sheh me sy, e jo më të futet në të. Aty do të futen diktatorët. Allahu thotë: ***(Ja ku po duket Xhehimi, ata po e shohin. Për atë, që e ka tepruar me zullumet e tij. Ai që i dha përparësi dynjasë, Xhehimi do të jetë vendi i tij.)***⁶⁴

Niveli i Pestë: XHEHENEM. Ky është niveli i tmerrit për ata që i munduan besimtarët në këtë botë. Do të jetë edhe për ata pabesimtarë të Ehli Kitabit (Çifutë e të Krishterë), dhe Mushrikë (Politeistë, Budistë, Hindusët, Ateistët...etj) Allahu thotë në Kuran: ***(Xhehenemi është aty në pritë. Për ata zullumqarët, do të jetë vendi i tyre. Ata do të qëndrojnë aty për shumë epoka.)***⁶⁵. Gjithashtu thotë: ***(Ata që munduan besimtarët dhe besimtarët, e nuk u penduan për ato që bënë, do të ketë për ta tortura në Xhehenem dhe tortura me djegie)***⁶⁶. Imagjinoni të gjithë ata kriminelë, diktatorë, e prokurorë e gjykatës, që munduan njerëzit në regjimin diktatorial të komunizmit. Aq sa kur e pyetën një lider të komunizmit tashmë në pension, nëse ishte penduar për çfarë kishte bërë? Ai tha: Jo, ashtu ishte koha dhe ne ashtu bëmë. Soji i tij, me lejen e Allahut e ka vendin pikërisht në këtë torturë. Allahu gjithashtu thotë për paganët: ***(Ata prej Ehli Kitabit (çifutet dhe krishterët), që nuk besuan po ashtu edhe mushrikët, do të hidhen në***

⁶² Kurani, Sure El Humeze, Ajetet 1-9

⁶³ Në fakt, është e pamundur të shpjegohen me shqipen tonë të gjitha llojet e zjarrit. Sepse nuk mundet në shqip, që ta përshkruajmë tmerrin e atyre torturave. Arabishtja këtu na ndihmon, për shkak të pasurisë së madhe të fjalëve të saj. Pasi fjala flakë gjigande, i përfshin ato.

⁶⁴ Kurani, Sure En Naziatë, Ajetet 36-39

⁶⁵ Kurani, Sure En Nebe, Ajetet 21-23

⁶⁶ Kurani, Sure El Buruxh, Ajeti 10

Xhehenem përjetësisht. Ato janë krijesat më të këqija)⁶⁷ El Bejine 16-17

Niveli i Gjashtë: SEKAR. Është quajtur kështu, sepse është një vend që i shkrin trupat që hidhen në të. Pavarësisht nëse janë njerëz, apo janë gurë, të gjithë shkrihen nga ai zjarr i tmerrshëm. Është për ata zullumqarë, që e njohën të vërtetën dhe e mohuan atë. E mohuan për të mos humbur interesat e tyre në këtë botë. E mohuan Kuranin, sepse u binte reputacioni. E mohuan Islamin, sepse nuk ishte në stilin e tyre të jetesës. Ata pra sot e kanë vendin në Sekar. Por çfarë është Sekar? ***(Ai djeg çdo qelizë, asgjë nuk shpëton prej tij. Lëkurën ta nxin nga tmerri. Mbi të qëndrojnë 19 zebanije të Xhehenemit.)***⁶⁸. Aty do të ketë edhe disa kriminelë të tjerë. Disa që edhe pse ishin muslimanë, bënë krime dhe kurrë nuk ia vunë kokën në Sexhde Allahut. ***(Banorët e Xhenetit do ti pyesin ata kriminelët: Çfarë ju futi në Sekar? Ata do të thonë: Ne nuk u falëm asnjëherë. Nuk ndihmuam asnjëherë të varfërit. Ishim kredhur në qefet tona. Gjithmonë e përgënjeshtroam ditën e Gjykimit. Derisa sa vdiqëm në atë gjendje. Sot atyre nuk do tu bëjë dobi asnjë ndërmjetësim.)***⁶⁹

Niveli i shtatë: SAIR: Këtu do të hyjnë ata barbarë, kriminelë, që libri do tu vijë nga pas shpine. Siç thamë më lart disa që i dinjë mirë tmerret që kanë shkaktuar për njerëzit, do duan të mos u vijë libri i tyre fare. Andaj edhe duart i fshehin. Por ai u vjen pas shpine, duke i ngecur në dorë. Të tillët sot po zhyten. Ata i kaluan të gjitha nivelet e mëparshme dhe nuk kanë ndaluar akoma zhytja. Derisa arrijnë aty në fund në Sair. Po kush janë ata? Ja çfarë thotë Allahu për ata: ***(Atij që libri do t'i vijë nga pas shpinës. Ah, ai do lutet që të zhduket fare. Por ai do të futet në Sair. Ai dikur jetonte në qejfe, në shoqërinë e tij. E mendonte se***

⁶⁷ Kurani, Sure El Bejine, Ajetet 16-17

⁶⁸ Kurani, Sure El Mudethir, Ajetet 26-30

⁶⁹ Kurani, Sure El Mudethir, Ajetet 41-48

nuk do të vinte kurrë, kjo ditë. Por Allahu gjithmonë e ka patur në mbikqyrje.)⁷⁰

VDEKJA VDES..

Pasi gjithçka ka përfunduar, janë caktuar në peshore kush ka shpëtuar dhe kush ka humbur. Para të gjithëve sillet vdekja në formën e një Dashi të madh.. Dhe Engjëjt e therin mes tyre.

Pastaj thërret një zë: O Banorë të Xhenetit, a e dini se kush është këtu? Ata thonë: Po e njohim. Është Vdekja. Atëherë gëzohuni pra, thonë engjëjt, se vdekja sot po vdes! Vdekje nuk ka më. Gëzoni të mirat e Zotit tuaj përjetësisht!

O Banorë të Xhehenemit, a e dini kush është këtu? Ata thonë: Po, e dijmë. Është vdekja. Atëherë engjëjt thonë: Mjerë për ju sot, se vdekjen që do ta dëshironi, sot po vdes! Vdekje nuk ka më dhe për ju ka vetëm vuajtje dhe tmerr.⁷¹

Pastaj Pejgamberi a.s lexoi ajetin: ***(Përkujtoji ata për atë ditën e Pishmaneve të mëdha. Atë ditë kur gjithçka ka marrë fund. Sepse sot, ata janë në Neglizhencë të madhe)***⁷²

Tashmë koncepti vdekje dhe zhukje nuk ekziston më.

Tashmë gëzohen banorët e Xhenetit dhe tmerrohen banorët e zjarrit.

⁷⁰ Kurani, Sure El Inshikak, Ajetet 10- 15

⁷¹ Bazuar në Hadithin e saktë, të gjendur në përmbledhjen e Shejh Albanit "Sahih al Xhamia" me nr 7998

⁷² Kurani, Sure Merjem, Ajeti 39

VETËM NJË MOMENT..

Papritur Allahu jep urdhër të marrin nga turma e njerëzve, njeriun ka shijuar gjithçka në jetën e Dynjasë. Ka qenë njeriu që nuk i ka munguar asgjë. Pushtet kishte; para kishte; shëndet po ashtu. Luks të madh përjetoi; femrat më të bukura i pati shërbëtore të tij. Por ai harroi ta njohë Zotin. Luksi i tij e verboi, e bëri mendjemadh, e bëri shtypës mbi njerëzit dhe mohues të Zotit. Ai merret dhe për një moment futet në Xhehenem dhe nxirret menjëherë. -Ishte ajo vizita si turist-. Mënxyrat dhe tmerri që e pa aty, ia fshiu të gjitha çfarë shijoi në këtë botë. -He more rob Im, e pyet Zoti, a ke parë ndonjëherë, diçka të mirë në atë Dynja? Jo, more Zot. Ku ka mirësi, pas atij tmerri që provova tani, përgjigjet mjerani

Përsëri Allahu urdhëron: Tani sillni këtu njeriun që në jetën e kësaj bote ka vuajtur më shumë. Sëmundjet, persekutimet, torturat. Atij iu dogj rinia burgjeve dhe birucave. Allahu jep urdhër të dërgohet vetëm një moment në Xhenet. Dhe pastaj ta sjellin përsëri aty. E do ta pyesë: O rob Im, a ke parë ndonjëherë vuajtje me sy? –Jo o Allahu im, kurrë nuk kam parë vuajtje me sy, përgjigjet i dashuri njeri. Ai moment, ai fllad, ajo madhështi e Xhenetit, ajo aromë, ajo bukuri, ia fshiu nga memorja krejt ditët e mënxyrës në të cilën ka jetuar për gjithë jetën e tij të dynjasë. Vetëm ai moment mjaftoi për ta ëmbëlsuar shpirtin e këtij njeriu.⁷³

HAKMARRJE E PAMUNDUR..

Ndërkohë që po bëhen gati të hidhen në Xhehenem, nisin më në fund të shpërthejnë mllefet e mëdha. Skllëvërit do të shpërthejnë ndaj pronarëve të tyre, rojat do të shpërthejnë ndaj Shefave të tyre. Ushtarët

⁷³ Bazuar në Hadithin e Saktë të transmetuar tek Muslimi, me nr. 2807

ndaj komandantëve të tyre. Të gjithë kanë vetëm një kërkesë: Hë pra ku jeni sot? Ne arritëm në këtë mënxyrë vetëm pse ju ndoqëm ju. Pse ju dëgjuam ju. Hë tani, na ndihmoni. Na hiqni një pjesë të dënimit.

(Atë ditë, kur do t`u rrotullohen fytyrat në zjarr, do të thonë: Ah sikur t`i ishim bindur Allahut e ti bindeshim Pejgamberit.. I drejtohen Zotit, (mjerueshëm) Por ne o Zot, iu bindëm eprorëve tanë, dhe ata na e humbën rrugën. O Zot! Dyfishoja atyre dënimin dhe hidh mbi ta një Mallkim të madh)⁷⁴

Të gjithë ata xhelatë, që masakronin njerëzit duke iu bindur regjimit. Të gjithë ata roja që vdiqën duke mbrojtur zullumqarët. Sot janë aty duke kafshuar gishtërinjtë e veta prej pendimit. Por nuk kanë asnjë dobi. Vetë shefat e tyre, eprorët, mbretërit e diktatorët, do të largohen prej tyre. Kanë hallet e veta. Pastaj turma e madhe e xhehenemlinjve, do ngrejë kokën në Qiell, e do t`i kërkojë Allahut të nxjerrë para tyre ata, dy kryesorët e zullumit. Iblisin prej Xhindeve dhe Dexhalin prej njerëzve. Allahu na e përshkruan këtë imazh të tmerrshëm të debateve që do të bëjnë në këtë moment:

(Ditën kur do të mblidhen armiqtë e Allahut, pranë zjarrit, për tu ndarë (sipas kategorisë ku do të hidhen). Para se të vinin në këtë vend, veshët, sytë dhe lëkura e tyre, kishin dëshmuar kundër tyre, për ato (veprat e liga) që kanë bërë. Ata i thonë lëkurës së tyre: Pse dëshmuat kundër nesh? Lëkura (dhe Gjymtyrët) thonë: Sepse na urdhëroi Allahu që të dëshmojmë. Ai që bëri të dëshmojnë të gjitha gjërat. Ai që ju krijoi herën e parë dhe që tani Atij po i ktheheni. Ju fshiheshit (duke mos lënë dëshmitarë), e nuk mendonit se do vinte kjo ditë. Dita kur do të dëshmojnë për ju, veshët tuaj, sytë, madje dhe lëkura juaj. Mendonit se Allahu nuk di shumë nga ato që ju vepronit. Kështu mendonit për Zotin tuaj!

⁷⁴ Kurani, Sure El Ahzabë, Ajetet 66-68

Por sot ja ku përfunduat, tashmë jeni të humbur. Sado trima të jenë, vendi i tyre është zjarri. Edhe sikur të bëjnë autokritikë, nuk do tu vlejë në këtë ditë. (Për shkak të ligësisë së tyre) U ngjitëm pas shokë të poshtër. Ata ua zbukuruan veprimet e këqija që bënë. Derisa këta, e merituan të vdisnin si zullumqarë. Ishin nga popuj të ndryshëm, që kaluan në histori, prej Xhindeve dhe Njerëzve. Ata ishin të ligj.

Zullumqarët u thoshin të tjerëve, mos e dëgjoni këtë Kuran, rrini larg tij, që të shpëtoni. Por sot këtyre zullumqarëve pabesimtarë, do t'ju japim një torturë të tmerrshme. Do t'ju shpaguajmë për krimet më të poshtër që bënë. Dënimi i armiqve të Zotit, është Zjarri. Aty do të jenë të torturuar përherë. Si shpagim, për mohimin e tyre ndaj argumentave Tona.

(Atëherë) Pabesimtarët do të thonë: O Allah na i nxirr para sysh ata të dy prej xhindeve dhe njerëzve, që na humbën në këtë derexhe. Duam që t'ju shkelim me këmbë sot, për të qenë më të poshtëruarit)⁷⁵

Atëherë përpara tyre del Iblisi dhe poshtë tij Dexhali. Megjithëse do të jetë krijesa me dënimin më të madh, përsëri Iblisi, as në atë moment nuk e braktis fodullëkun e tij. Ai del para tyre me fodullëk dhe u thotë:

(..Allahu ju premtoi me të Drejtën dhe e mbajti Premtimin e Tij. Ndërsa unë ju premtova dhe ju mashtrova. Por unë nuk kisha asnjë fuqi, për t'ju ndryshuar ju. Thjesht ju ftova dhe ju mu përgjigjët, Me zor nuk ju mora. Sot mos më mallkoni mua, por mallkoni veten tuaj. Unë nuk do të mund t'ju ndihmoj asgjë në torturat që do të provoni. As ju nuk mund të më ndihmoni në torturat e mia. Unë sot i mohoj të

⁷⁵ Kurani, Sure Fussilet, Ajetet 19-29

gjitha aleancat tona të mëparshme. Zullumqarët sot do të kenë dënim të tmerrshëm.)⁷⁶

Sot do të duket vërtetësia e zotave që njerëzit adhuruan. Të gjithë i kanë braktisur. Ata që adhuruan Jezusin si zot, dhe nënën e tij Marinë, si Shenjtore, sot do të zhgënjehen prej tyre. Ata janë shumë larg tyre, nën Hijen e Arshit të Zotit, duke pritur të futen në Xhenet. Ndërsa këta që i adhuronin, po shkojnë në zjarr. Aty në zjarr do të jenë edhe priftërinjtë, që i devijuan ata. Sepse Jezusi është i pastër dhe i pafajshëm nga paganizmi i tyre. Andaj sot nuk janë bashkë.

Aty do të jenë edhe shumë idhuj të tjerë. Do të jenë aty edhe idhujt e muzikës, idhujt e bankave, idhujt e politikës dhe idhujt e nacionalizmave. Të gjithë sot janë mbledhur dhe po bëhen gati të hidhen në dënimin e përhershëm. Atë dënim, që nuk e çuan kurrë në mendje. Sot është realitet.

(Shijojeni pra atë dënim. Për shkak se ju kurrë nuk e çuat në mendje këtë ditë. E sot, po ju harrojmë. Provoni dënimin e tmerrshëm, përjetësisht, për shkak të veprave tuaja)⁷⁷

Ndërkohë që një fenomen i habitshëm ndodh me kafshët. Ato nisin të treten, të bëhen dhë. Aty para syve të njerëzimit dhe Xhindeve, kafshët po zhduken. Atëherë pabesimtarët do të thonë: Ah i mjeri unë, të isha bërë dhe unë dhe, si këto!

(U kemi njoftuar se ky dënim është afër. Dita kur njeriu do të shikojë punët e veta. E do të thotë pabesimtari: Ah i mjeri unë, të isha bërë më mirë dhe)⁷⁸

⁷⁶ Kurani, Sure Ibrahim Ajeti 22

⁷⁷ Kurani, Sure Es Sexhde, Ajeti 14

⁷⁸ Kurani, Sure En Nebe`, Ajeti 40

KAPITULLI I PESTË

ZEBANIJET E XHEHENEMIT..⁷⁹

Fillon të ndodhi ajo, më e keqja..

Derdhja e turmave njerëzore dhe të xhindeve në Xhehenem. Skenë e tmerrshme mes britmash dhe ulërimash, vajtimesh të pashpresa dhe të përvuajtshme. Mirpo engjëjt që janë krijuar për të torturuar xhehenemlinjtë, janë aty dhe ata janë të pamëshirshëm. Ata kanë marrë urdhërin të kapin zvarrë të gjithë banorët e zjarrit.

Zebanije quhen këto krijesa të rrepta të Zotit, që merren me këtë punë. I kapin për koke, për flokësh, për trupi dhe i flakin në Xhehenem. Ata nuk ndjejnë keqardhje. Nuk kanë në zemrën e tyre mëshirë. Në fakt nuk janë krijuar për mëshirë. Ata i marrin një nga një dhe i lidhin me zinxhirë. Engjëjt i lidhin njerëzit nga duart dhe këmbët dhe pastaj ua lidhin edhe qafën me këta zinxhirë.

(Për pabesimtarët kemi përgatitur zinxhirë, pranga dhe flakë të zjarrit)⁸⁰

Pastaj ashtu të lidhur, këmbë e duar, i zhysin secilin në nivelin që duhet të arrijnë. Por trupi i njeriut është mish e gjak. Menjëherë sapo provojnë erën e zjarrit në Xhehenem, u digjet lëkura, u përcëllohen fytyrat, u thahet uji i syve, u nxihet trupi. E në fakt janë akoma në fillim.

Hidhen aty të gjithë barbarët, kriminelët, pabesimtarët, skeptikët. Ata që thonin jam agnostik, ata që thonin jam ateist, ata që thonin kam fe tjetër, nuk më duhet fare kjo që thoni.

⁷⁹ Janë Engjëjt të krijuar nga Allahu i Madhëruar, posaçërisht për të torturuar banorët e zjarrit. Edhe pse janë Engjëj, nuk dmth se janë të butë, të ëmbël dhe të mëshirshëm. Përkundrazi janë sinonim i tmerrit, i frikës dhe horrorit..

⁸⁰ Kurani, Sure El Insan, Ajeti 4

(Ndërsa ata të poshtërit, vendi i tyre është zjarri. Sa herë përpiqen të dalin prej aty, zhyten përsëri aty. Atyre u thuhet: Shijojeni pra dënimin që ju e përgënjeshtrohet)⁸¹

Janë ata që thonin jam komunist, socialist, demokrat, kapitalist, jam agnostik, liberal, majtist, etj. Të gjithë ata sot janë lëndë djegëse e Zjarrit. Allahu thotë në Kuran: ***(O ju që keni besuar, ruajeni veten tuaj dhe familjen tuaj nga Zjarri. Lënda djegëse e të cilit, janë njerëzit dhe gurët.)***⁸²

Turma turma, mes përgjërimesh, vazhdon hedhja e kriminelëve në Xhehenem.

(E merren pabesimtarët, turma turma për Xhehenem. Kur vijnë aty, hapen dyert e tij. Rojat u thonë: A nuk ju erdhën peygamberët tuaj, që tju tregojnë argumentat e Zotit tuaj? E tju paralajmëronin për këtë ditë? Ata thonë: Po na thanë. Por (nuk e besuam dhe tani) si pabesimtarë, kemi merituar dënimin. U thuhet: Hyni pra në dyert e Xhehenemit, përjetësisht në të. Sa vend i keq është ky për pabesimtarët.)⁸³

Shkojnë secili në gropën që është përcaktuar për të. Aty e pret mundimi i përjetshëm. E presin zëbanijet e torturës. Sa herë që u digjet lëkura, u zëvendësohet atyre me lëkurë tjetër.

(Ata që mohuan argumentat Tona, do ti hedhim në zjarr. Sa herë që lëkura e tyre digjet, ua zëvendësojmë me lëkurë tjetër. Për ta shijuar kështu, dënimin. Allahu është i Plotfuqishëm dhe i Gjithëdijshtëm)⁸⁴

⁸¹ Kurani Sure Es Sexhde, Ajeti 20

⁸² Kurani, Sure Et Tahrim, Ajeti 6

⁸³ Kurani, Sure Ez Zumer, Ajetet 71-72

⁸⁴ Kurani, Sure En Nisa, Ajeti 56

Duhet që ata ta provojnë vazhdimisht dhimbjen. Shumë prej tyre duan të arratisen, por nga tia mbajnë? Kudo vendi është rrethuar me llavë e me tmerr. Male të larta me zjarr, shtypin turmat e njerëzve dhe xhindeve aty poshtë. Ata po notojnë në llavë. Digjen dhe rigjenerohen përsëri. Asgjë nuk mbaron, asgjë nuk ka fund. Nuk ka vdekje aty. Vdekja ka mbaruar me kohë.

(Ata të cilët nuk kanë besuar, do të jenë në zjarr. Aty nuk do të vdesin, që të zhduken. As nuk do tu lehtësohet dënimi. Ky është shpërblimi për Pabesimin)⁸⁵

Aty edhe trimëria shkrihet. Nuk ka trim, që do të durojë si burrë tmerrin e Xhehenemit. Edhe nëse dikush do të marrë mundimin të durojë, atij do t'i këputen shpresat, kur e di se kjo nuk ka fund. Se nuk do të vijë një ditë, që ai do të dalë nga aty, për shkak të durimit që ka bërë.

(Do të hidheni aty, duroni, ose nuk duroni, nuk ka asnjë ndryshim për ju. Po dënoheni për çfarë keni vepruar)⁸⁶

Aty edhe dashuritë e mëdha që adhuruan veten dhe jo Zotin, do të bëhen armiq të mëdhenj. Aty askujt nuk do ti bjerë mendja për asgjë. Besnikëritë u harruan, dashuritë po ashtu, dhembshuritë për njëri-tjetrin u shkrinë. Secili merret me hallet e veta. Secili ka zinxhirë lidhur këmbë e duar e qafë. Ata po hiqen dhe po përpiqen nga Zebanijet, si lecka e lagur që përpiket mbi shkëmb. Edhe ata përplasen në shkëmbinjtë e zjarrit. Pastaj zhyten në llavë. Nuk kanë kohë të ankohen, se përsëri merren dhe përpiqen mbi llavë.

⁸⁵ Kurani, Sure Fatir, Ajeti 36

⁸⁶ Kurani, Sure Et Tur, Ajeti 16

KOHA E USHQIMIT..

Pastaj u serviret diçka që të ushqehen, diçka që të pijnë. Ushqimi i tyre quhet Zekum dhe Gislinë.

(Ushqim me gjemba, dhe dënim të dhimbëshëm)⁸⁷

(Ushqimi do të jetë vetëm prej qelbësirës)⁸⁸

(Do të hanë prej pemës Zekum, do të mbushni barqet me të, pastaj do të pini ujë të vluar. Do të pini të pangopur)⁸⁹

(Pema e Zekumit, do të jetë ushqimi i të poshtërve. Ajo vlon në barkun e tyre si llavë e shkrirë. Merreni dhe hidheni në mes të Xhehenemit. Pastaj si dënim, derdhni mbi kokën e tij, ujë të vluar. Shijo pra tani, ti që mbaheshe si i fuqishëm dhe soj i lartë)⁹⁰

Çfarë ushqimi?!

Zekum është një frut me gjemba, që as ushqen dhe as ngop. Por thjesht ua çan fytin dhe këput zorrët. Ata do të hanë për t`u torturuar dhe jo për t`u ushqyer. Ka mbaruar koha e ushqimit dhe qefit për ta. Koha kur ata provonin kënaqësi, tashmë ka mbetur e Shkuar.

Sot është e Tashmja dhe e Ardhmja. Dhe e tashmja, por edhe e ardhmja, për ta është torturë. Është tuneli që nuk ka dritë në fund të tij. Do t`u jepet edhe ujë për të pirë, por jo për të shuar etjen. Uji është i valuar dhe për më tepër është i ndyrë. Është qelb që nxjerrin trupat e tyre.

Tashmë është fundi i Xhehenemit..

⁸⁷ Kurani, Sure El Muzemil, Ajeti 13

⁸⁸ Kurani, El Hakka, Ajeti 36

⁸⁹ Kurani, Sure El Vakia, Ajetet 52-55

⁹⁰ Kurani, Sure Ed Dukhan, Ajetet 43-49

Në fund fare aty në Xhehenem, në Seir, aty janë ata më të ligjtë. Janë ata që në këtë botë u gënjeu mendja se ishin zota. Ata që në këtë botë shkelnin me këmbë të gjithë njerëzit. Janë Iblisi, armiku më i madh i njeriut. Ai mashtruesi që i nxorri nga rruga shumë njerëz. Ai që u mallkua prej mendjemadhësisë së vet. Aty bashkë me të do të jenë edhe ata mendjemëdhenjtë, që Zotin nuk e besuan. Do të jetë Faraoni Ramses dhe shumë faraonë të tjerë të kohëve të ndryshme të historisë njerëzore. Do të jenë vrasësit barbarë, që arma e tyre nuk mëshiroi asnjë njeri, plak, grua apo fëmijë.

Torturat në Xhehenem nuk kanë të përshkruar. Fjala është e varfër, për të treguar mënxyrat e Xhehenemit. Mjafton të themi se dënimi më i vogël në Xhehenem është vendosja e gurëve të nxehtë në mes të gishtave të këmbëve, nga ku trutë në kokë vlojnë prej tmerrit.

Në Xhehenem nuk ekziston fjala mëshirë, ekziston vetëm fjala zemërim dhe torturë.

Por në Xhehenem nuk do të hyjnë vetëm Pabesimtarët. Aty do të hyjnë edhe ata besimtarë që e ngarkuan veten e tyre me gjynahe. Ata që i vazhduan gjynahet dhe nuk u penduan.

Por ndryshe nga pjesa tjetër, për ata ka shpresë se një ditë do të dalin nga aty. Ata do të mbarojnë dënimin e tyre dhe do të dalin. Disa do të qëndrojnë aty një vit, disa një ditë, disa të tjerë me qindra vjet, disa me më shumë e disa më pak.

Por ata e dijnë se do të dalin një ditë nga aty. Janë ata që besuan Allahun gjithsesi. Edhe pse bënë gjynahe, madje edhe krime. Por në zemër kishin sadopak besim.

KAPITULLI I GJASHTË

SHUMË KOHË MË VONË..

Allahu e di se kur do të ndodhë. Ka kaluar shumë kohë e gjatë..Por do të ndodhë..

Allahu urdhëron Engjëjt e zjarrit: **NXIRRNË NGA ZJARRI KËDO QË KA PATUR NË ZEMRËN E TIJ NJË GRIMCË TË VOGËL BESIMI.. !⁹¹**

Dhe Zebanijet e zjarrit nxjerrin nga llava, e tmerrit disa trupa që nuk janë as gjallë dhe as vdekur. Janë të shkrumbuar e nxirë dhe nuk kanë asnjë shenjë jete në fakt. Por ato nuk kanë vdekur, sepse sic thamë, vdekja nuk ekziston. Ato trupa nxirren në bregun e Xhehenemit dhe dërgohen nga aty në Xhenet.. Por para se të hyjnë brenda, ata njomen me ujin e jetës. Uji që do rigjenerojë të gjitha qelizat e tyre. Nisin të marrin shenjat e jetës. Trupi gjallërohet, nisin të ngrihen në këmbë. Tani janë bërë gati për të hyrë në Xhenet. Por historinë e tyre do ta vazhdojmë më vonë.

Le të kthehemi pas në kohë. Jo shumë, disa qindra apo mijëra vjet. Për pafundësinë, kjo është kohë e shkurtër..Do të kthehemi pikërisht, në ditën kur Vdekja vdiq.

XHENETI ËSHTË ZBUKURUAR..

Në Xhenet ka festë. Për herë të parë ai do të mbushet me banorët e vet. Engjëjt e Xhenetit janë rreshtuar dhe buzëqeshin. Janë rreshtuar të gjithë për të hyrë në Xhenete. Tashmë në fushën e madhe të Xhenetlinjve aty jashtë, ka gëzim të madh. Njerëzit flasin me njëri

⁹¹ Bazuar në Hadithin e saktë tek Buhariu me nr. 22 dhe tek Muslimi, me numër 184

tjetrin. Të gjithë bisedojnë për çfarë kaluan në Dynja. Flasin për vuajtjet e tyre, për durimin. Ka edhe prej atyre besimtarëve që në Dynja ishin zemëruar me njëri tjetrin. Sot zemërimet e tyre janë fshirë. Të gjithë përqafohen. Aty fillimisht të gjithë janë të mbuluar. Nuk janë më si në fillim, kur sapo kishin dalë nga varri i tyre. Të gjithëve u janë dhuruar rroba Xheneti dhe askush nuk është i zbuluar.

(E kemi pastruar nga zemra e tyre, çdo mëri. Ata do të jenë në vende ku do të rrjedhin lumenj, poshtë këmbëve të tyre. Do të thonë: Elhamdulillah, Faleminderit Allahut që na udhëzoi për këtë mirësi. E ku do mundeshim dot vetë, ne? Sikur të mos na udhëzonte Allahu? Na erdhën Pejgamberët e Zotit, me të vërtetën. Ata do të thirren: Ky është Xheneti që e fituat me veprat që i keni bërë.)⁹²

HAPEN DYERT E XHENETIT..

Një flad i freskët aromatik vjen nga brenda. Fytyrat e xhenetlinjve freskohen dhe ndriçohen. Me fjalët dhe këngët më të bukura. Fillon ceremonia e Hyrjes në Xhenet.. Engjëjt hapin portat e Xhenetit: Hyni në xhenet, o të dashur! Hyni në Xhenet për çfarë jeni munduar, në jetën e asaj bote! Hyni në Xhenet, se sot nuk ka më frikë dhe as dëshpërim për ju! Hyni në Xhenet me Paqe dhe me Dashuri prej Allahut! Hyni në Xhenet, ju jeni të dashurit e Allahut! Ju jeni të zgjedhurit. Ju jeni të bekuarit.

(E po merren ata që ishin të devotshëm me Zotin e tyre, grupe-grupe. Kur vijnë aty, u hapen dyert dhe u thonë Rojtarët e Xhenetit: Paqja qoftë me ju! Ishit të mirë, andaj hyni aty përjetësisht)⁹³

⁹² Kurani, Sure El E`arafë, Ajeti 43

⁹³ Kurani, Sure Ez Zumer, Ajeti 73

Hyjnë në fillim ata që nuk ishin në Peshore, në vendin e llogarisë. Ata janë të kapur krah për krah me njëri-tjetrin. Thamë më lart se porta e Xhenetit është e gjerë sa distanca nga Meka në Busra.⁹⁴ Dmth rreth 1300 km.

Futen në turma të mëdha. Hyjnë prindërit me fëmijët e tyre. Hyjnë fëmijët duke marrë përdore prindërit e tyre.

Mirpo disa hezitojnë të hyjnë. Ata i luten Allahut, të mos hyjnë vetëm. I luten Allahut për prindërit e tyre, që janë atje matanë duke pritur të kalojnë Urën e Siratit, apo që e dijnë se janë për Xhehenem. I luten Allahut t'i falë ata, për hatrin e tyre. Të mos ua thyejë zemrën me humbjen e tyre.

Dhe mrekullia ndodh. Nga turmat e Xhehenemlinjve zgjidhen disa që merren prej aty dhe dërgohen edhe ata në anën tjetër. Pavarësisht se në Peshore kanë qenë të dështuar. Janë fëmijët e tyre, janë prindërit e tyre, janë vëllezërit e tyre të mirë, që e kanë lutur Allahun për ata. Dhe Allahu ua ka pranuar lutjet. Sot ata shpëtuan.

(Atyre që besuan, do t'ua bashkangjisim edhe pasardhësit e tyre që i ndoqën në besim.)⁹⁵

Aty në vendin e xhehenemlinjve shumë të tjerë do t'i lakmojnë ata. Por përzgjedhjen e ka bërë Allahu, Krijuesi i botëve. Ai përzgjedh të gjithë, sipas asaj që Ai ka parë tek zemrat e tyre dhe jo sipas asaj që të tjerët shohin.

Nga ana tjetër, Allahu ka hequr nga zemrat e Xhenetlinjve, çdo dashuri për prindërit dhe të afërmit e tyre që vdiqën pa besim në Allah. Sot ata do të jenë të huaj për njëri-tjetrin.

⁹⁴ Bazuar në Hadithin e saktë tek Buhariu me numër: 4712

⁹⁵ Kurani, Sure Et Tur, Ajeti 21

Qofshin ata prindërit, vëllezërit dhe motrat, fëmijët, apo bashkëshortët. Aty do të bëhet ndarja përfundimtare. Një grup për Xhenet dhe tjetri për në zjarr.

E mbani mend më lart? Atje tek peshoret, kur po jepte llogari..Pabesimtari ishte dakord që edhe njerëzit më të afërt t'i jepte në Xhehenem, vetëm ai të shpëtonte.

(Do t'u mundësohet të shihen. Mëkatari dëshiron që atë ditë ta kompenzojë veten (lirojë) nga dënimi i asaj dite me fëmijët e vet; edhe me bashkëshorten e vet; dhe vëllanë e vet; dhe me familje të vet që e strehuan dhe rritën; more kush është në tokë, të gjithë së bashku, vetëm ait ë shpëtojë..)

Epo tani ka ardhur koha, që këta do ta braktisin atë. Nuk ka më dashuri, as respekt. Allahu e ka hequr ndjenjën e dhembshurisë nga zemrat e Xhenetlinjve, për ata banorët e Xhehenemit. Përderisa Allahu është i zemëruar me ta, nuk ka si të kenë dhembshuri krijesat e Tij.

Në fund fare, prindi ishte thjesht mjeti për të sjellë në jetë një krijesë që Allahu e ka krijuar të veçantë. Atje, në fillim fare, secili ishte krijuar unik në llojin e vet.

Sot e vetmja dashuri që do të mbijetojë, është dashuria për hatrin e Allahut. Është dashuria që ka pasur si qëllim Allahun, Krijuesin e Dashurisë.

XHENETI, ËSHTË KREJT DIÇKA TJETËR..

Xheneti, vendi ku Allahu ua ka premtuar besimtarëve, është krejt diçka tjetër, nga çdo lloj bukurie që njeriu ka parë ose imagjinuar në këtë botë.

Atje gjithçka është perfekte. Është perfekte toka, e cila dheu i saj ka aromë të mirë. Është perfekte pamja dhe ngjyrat e saj. Janë perfektë lumenjtë që rrjedhin në gjithë atë peisazh. Është perfekte infrastruktura e ndërtimeve të pallateve dhe kështjellave mbretërore që gjenden kudo. Lumenj qumështi rrjedhin aty pranë. Lumenj mjalti gjithashtu rrjedhin përbri. Rrjedhin edhe lumenj me verë dhe shumë pije të tjera, të njohura dhe të panjohura prej njeriut deri më sot.

Përshkrimi i Xhenetit që u është premtuar të devotshmëve, është ky: Aty do të ketë lumenj me ujë të pashtershëm. Lumenj prej qumështi që nuk i ndryshon shija e tij. Lumenj vere të shijshme për ata që e pijnë. Lumenj mjalti të kulluar. Aty do të kenë të gjitha llojet e frutave dhe falje mëkatesh nga Zoti i tyre..)⁹⁶

BURIMI I KEUTHERIT..⁹⁷

Në sheshin e madh ku xhenetlinjtë sapo kanë hyrë, gjendet aty një burim i madh me ujin e Jetës. Uji që pasi ta pish, nuk do të kesh më etje. Në fakt aty çdo gjë që konsumohet, nuk konsumohet për nevoja fiziologjike. Konsumohet vetëm për qef. Sepse ka mbaruar koha e nevojave. Tani është koha e kënaqësive.

Në burimin e Keutherit secili Pejgamber, pret ndjekësit e tij. Muhamedi a.s po u servir të gjithë Xhenetlinjve të Umetit të vet, ujë nga Keutheri. Ai u thotë atyre: Pini dhe gëzohuni! Për ju nuk ka më etje.

⁹⁶ Kurani, Sure Muhamed, Ajeti 15

⁹⁷ Është një Burim që rrjedh në formë Lumi, në Xhenet. Aty, të gjithë që do të pijnë ujë, do tu shuhet etja. Quhet Keuther pra i Bollshëm, i Ngopshëm, pas një etje dhe vështirësie të madhe. Është ai ujë qetësuesi dhe prehësi për trupin..

Allahu e di shijen që ka ai ujë. Ne ujë kemi pirë dhe e dijmë që është pa shije. Por ai është uji i Keutherit. Diçka krejt tjetër. Pijmë të gjithë aty dhe shijojmë kënaqësinë e atij uji.

KAPITULLI I SHTATË

AKOMODIMET NË BANESËN E PËRHERSHME.

Fillimisht Pejgamberët dhe familjarët e tyre merren dhe ngjiten në gradën më të lartë, në atë që quhet Xheneti Firdeus. Qielli i këtij Xheneti është Arshi i Allahut të Madhëruar. Por do t' i tregojmë më vonë çfarë ka brenda në të.

Pastaj vijnë dëshmorët. Engjëjt e Allahut i ngrejnë lart edhe ata që dhanë jetën dhe shpirtin e tyre, në rrugë të Allahut. Të gjithë ata që nuk u kursyen për të mbrojtur të vërtetën; për të mbrojtur të dobëtit; për të mbrojtur Islamin; e për të mbrojtur namazin e agjërimit. Të gjithë ata që u vranë apo vdiqën në burgje, sepse refuzuan nënshtrimin ndaj zullumqarëve. Të gjithë ata që luftuan për lirinë e vatanit të tyre, por që kërkuan me këtë, kënaqësinë e Allahut.

Madje shehidat që do të ngrihen janë edhe ata që vdiqën si viktima të zullumqarëve. Ata që u vranë padrejtësisht, që u dogjën në masakra të ndryshme, që barbarët kryen.

Do të jenë pjesë e shehidave edhe ata që vdiqën nga epidemitë shkatërruese në kohë të ndryshme. Do të jenë shehida edhe ato zonja besimtare që vdiqën në lehoninë e tyre, duke dhënë jetë të re për fëmijët që lindën.

Do të jenë shehida edhe ata që vdiqën nga tërmetet dhe nga përmytjet. Sot të gjithë këta njerëz janë në gradat më të larta të Xhenetit.

(Ata që iu bindën Allahut dhe Pejgamberit, do të jenë sëbashku me ata që Allahu i ka privilegjuar, me Pejgamberët, me të drejtët, me

dëshmorët dhe me njerëzit e mirë. Ajo vërtetë është shoqëri shumë e mirë)⁹⁸

Pastaj do të vijnë dijetarët.. Atyre u thuhet, le të ngrihen lart Hafizat e Kuranit! Engjëjt do ta marrin secilin prej tyre dhe do t'i thonë: Me çdo ajet që do të lexosh, do të ngjitesh edhe më lart. Ku të ndalosh aty do ta kesh edhe vendin tënd. E kështu nisin hafizat e Kuranit të ngjiten. Ata që shkojnë më lart, janë ata që e kanë mësuar krejt Kuranin.⁹⁹

Por më lart tyre janë edhe ata dijetarët që Kuranin e mësuan dhe mësuan edhe hadithet. Pastaj dhanë dituri për njerëzit. Këta do të kenë grada pranë Pejgamberëve a.s. Sepse ata ishin trashëgimtarët e Pejgamberëve në misionin e tyre. Të gjithë ata dijetarë të sinqertë, që mësuan njerëzimin për rrugën e drejtë, të gjithë ata që e zbatuan vetë atë që thanë. Sot të gjithë këta janë aty pranë, fqinjë me Pejgamberët e Allahut të Madhëruar. Pranë tyre janë edhe dëshmorët që i përmendëm më lart. Të gjithë këta janë në gradën më të lartë të Xhenetit. Atje mbi ta, është vetëm Arshi i Allahut të Madhëruar.

Nisin pastaj të ngjiten ata në xhenetet e tjera. Në Xhenetin e Adnit, e në shumë e shumë xhenete të tjera që Allahu ka përgatitur për robërit e Tij të dashur.

ELITA E NJERËZIMIT..

Të gjithë mendojmë se Elita janë njerëzit më të pasur të kësaj bote. Ata që jetuan një jetë luksi dhe aristokracie këtu në këtë botë. Por ajo kohë tashmë ka shkuar. Shumica e atyre që ishin elita e Dynjasë dhe aristokracia e saj, sot janë në Xhehenem. Në Xhenet, atje në Mbretërinë

⁹⁸ Kurani, Sure En Nisa, Ajeti 69

⁹⁹ Bazuar në Hadithin e saktë që gjendet tek Ebu Daudi, i verifikuar prej Albanit, me nr. 1464

Qiellore, ligjet janë krejt ndryshe. Atje Elita dhe Aristokracia do të jenë shumica e atyre, që në këtë botë ishin të përvuajtur.

Do të jenë shumë prej atyre që në këtë botë askush nuk i përfillte. Do të jetë ai plaku në Xhaminë tënde që mezi e këndon Fatihanë në Namaz dhe mezi qëndron në këmbë. Por asnjëherë nuk përtonte të vijë në çdo namaz dhe të jetë në Safin e parë. Do të jetë ai muezini i Xhamisë që askush nuk e ndjente në mëngjes herët, kur vinte me biçikletën e tij në çdo kohë, në të ftohtë dhe në të nxehtë. Në verë dhe në dimër. Kur të gjithë ishin në gjumë, ai merrte biçikletën dhe rendte me shpejtësi për të shkuar në Xhami, e për të thirrur Ezanin e Sabahut. Sot është koha që ai të jetojë si një aristokrat i vërtetë.

PAMJE PERFEKTE DHE RINI E PËRHERSHME..

Në Xhenet pamjet e xhenetlinjve do të jenë perfekte. Në kulmin e bukurisë. Thuhet se burrat do të kenë bukurinë e Jusufit a.s, Ndërsa gratë do të kenë bukurinë e Havasë a.s, gruas së Ademit a.s.

Ata do të jenë madhështorë, të gjatë dhe të plotë, as të shëndoshë dhe as të dobët. Do të jenë kulmi i perfeksionit trupor dhe fizik. Moshë dhe shëndeti i tyre do të jetë në moshën e Isait a.s para se të ngrihej nga kjo botë. Dmth do të jenë nga 33 vjeçarë të gjithë. Nuk do të kenë flokë të rëna dhe as rrudha në fytyrë.¹⁰⁰

Kështu do të jenë edhe ata që vdiqën në moshë shumë të vjetër. Edhe ata që vdiqën në moshë shumë të re. Edhe nëna edhe babai edhe djali edhe vajza, të gjithë në fakt do të jenë në moshën 33 vjeçare. Sepse nëna dhe babai në fakt nuk janë ata krijuesit e vërtetë të fëmijëve të tyre. Ata ishin thjesht mjetet për t'i sjellë në jetë fëmijët e tyre. Në fakt

¹⁰⁰ Bazuar në Hadithet e sakta të Pejgamberit a.s të transmetuara nga Imam Taberani në Muaxhem el Saghir, me nr.1164. Hadithi vjen në versione të ndryshme.

Krijuesi i vërtetë është Allahu i Madhëruar. Kështu të gjithë do të jenë në të njëjtën moshë dhe status.

E vetmja lidhje e qëndrueshme do të jetë ajo që edhe në këtë botë është lidhja më e ngushtë. Lidhja fizike e njeriut me njeriun. Pra Burri me Gruan e vet, atje do të jenë të njëjtë të martuar dhe të lidhur me njëri-tjetrin. Ata do të i përkasin njëri tjetrit.

Ndërsa prindërit do të kenë jetën e tyre me njëri-tjetrin, si bashkëshortë. Edhe fëmijët po ashtu do të kenë jetën e tyre me bashkëshortët e tyre. Ndërsa raportet e tyre do të jenë raporte mes miqsh që vizitojnë njëri-tjetrin.

Ata që shkuan nga kjo botë si beqarë, qofshin meshkuj ose femra, atje do të martohen.

Madje atje do të martohen edhe ata të cilët mbetën pa bashkëshortë. Pasi njëri prej bashkëshortëve ishte banor i Xhehenemit, ndërsa tjetri banor i Xhenetit, ata janë ndarë dhe kanë harruar çdo lidhje që kanë patur më parë.

Shumë gra, që u munduan nga burrat e tyre pabesimtarë, sot do të jenë vajza të bukura beqare, që do të martohen me djemtë e bukur beqarë, që shkuan nga kjo botë të pamartuar.

Mirpo çiftet në Xhenet nuk do të jenë si çiftet në këtë botë.

Atje një burrë besimtar do të ketë për nuse të tij dy gra besimtare të kësaj bote. Ndërsa do të ketë edhe shumë hyri të Xhenetit të cilat në fakt janë femrat e haremit të tij.

Prit pak! Haremit të tij? Pse a ka edhe atje në Xhenet Harem?

Në fakt, Haremi ashtu si e ka kuptimin e vet të vërtetë, do të thotë vatra e shtëpisë së njeriut. Vendi ku jeton familja e tij e ngushtë. Dmth

vendi ku jetojnë gratë dhe femrat e familjes. Sigurisht që është i mbyllur dhe ka privatësinë e tij. Nuk është i hapur për të gjithë. Kështu edhe në Xhenet, burri do të ketë ambjentet e tij të privatësisë dhe femrat e tij që janë Hyritë. Diçka e ngjashme si pallati i Sulltanit, sepse të gjithë atje do të jenë Sulltanë. Por atje është shumë herë më perfekte.

Por si përkthehet e gjitha kjo për gratë besimtare të Xhenetit?

Raportet në fakt janë përcaktuar që në këtë botë. Gruaja i përket një burri. Ndërsa Burri mund të ketë më shumë se një grua.

Në këto raste, në Xhenet kjo pjesë sociale do të rregullohet edhe më mirë. Burri i gruas në Xhenet, do të ketë fuqinë e 100 burrave të kësaj bote. E këtu po flasim për fuqinë në Ushqim, në pije dhe në Pasionë.. Por edhe fuqinë seksuale.¹⁰¹

Kështu zemra e gruas mbahet e lidhur me burrin e saj. Ajo është e tij, është thesari i tij. Ajo nuk mund të shkojë në duar të tjera. Ajo mbetet e tij, me të gjitha kënaqësitë që Allahu ka krijuar për gruan besimtare, aty në Xhenet. Gjithçka që ëndërron ajo, do ta gjejë tek burri i saj. Por edhe zemrën edhe sytë edhe trupin ajo do ta ketë vetëm për burrin e saj. Në fakt duke qenë mbretëreshë në Xhenet, bashkë me burrin e saj, ajo do të jetë plotësisht e lidhur me mbretin e saj.

BANESAT E XHENETLINJVE..

Ata nuk do të jetojnë në apartamente siç janë mësuar të jetojnë në këtë botë të vogël. Ata secili do të ketë kështjellën e tij. Do të ketë mbretërinë e tij, ku burri dhe grua do të jenë sovranë në mbretërinë e tyre. Ata do të kenë çdo gjë në shërbimin e tyre.

¹⁰¹ Bazuar në Hadithin e saktë të Pejgamberit a.s, I transmetuar nga shumë dijetarë të Hadithit, prej tyre Ibn Hibani, me nr. 7424, Imam Ahmedi me nr. 19269, Nesaiu me nr. 11478, etj..

Për secilin banor të Xhenetit do të ketë nga një mbretëri. Me plot kuptimin e fjalës mbretëri. Ajo do të ketë gjerësinë e qiejve dhe të tokës. Do të ketë pallatet e veta, që janë të ndërtuara, jo me gurë të thjeshtë. Por janë ndërtuar me gurë floriri ose diamantesh ose smeraldesh. Gjithçka që i duhet, aty e ka. Froni i mbreti dhe shtrati i tij madhështor, do të jenë të gjitha për këtë Xhenetli.

HURITË E XHENETIT¹⁰²

Por çfarë janë Huritë e Xhenetit?

Ja si i përshkruan Allahu i Madhëruar, ato, në Kuran:

(Do t'i martojmë ata me Huri, sybukura)¹⁰³

Huritë, janë zonjusha bukuroshe, të bardha, me sy të zeza shumë të bukura. Nuk i ka prekur askush më parë. Janë vetëm burrat e tyre që po i prekin kur të futen në Xhenet. As xhindet, as njerëzit, nuk kanë patur mundësinë t'u afrohen atyre.

E ka pyetur Umu Seleme Pejgamberin a.s për gratë e Xhenetit. E Pejgamberi a.s i ka përshkruar kështu: *[HURITË E XHENETIT, janë bardhoshe me sy të mëdhenj, me flokët bjondina rrezatuese, si krahu i shqiponjave. Dëlirësia e tyre është si ajo Perla në një guaskë të pahapur nga dikush. Ato janë të mirat në sjelljet e tyre dhe të bukuroshet në pamjen e tyre. Janë të veshura me pëlhura – siç e përshkruan Pejgamberi a.s- të holla dhe delikate si ajo membrana e brendshme e vezës.]*¹⁰⁴

¹⁰² Janë Vajza të kulluara nga Bukuria. Ato janë krijuar në Xhenet të ngjashme me racën njerëzore. Personifikim i idealeve në një femër.

¹⁰³ Kurani, Sure Ed Dukhanë, Ajeti 54

¹⁰⁴ <https://quran.ksu.edu.sa/tafseer/katheer/sura56-aya36.html>

[Nëse një grua prej Xhenetit do të shfaqej në tokë, do të ndriçonte krejt tokën deri në qiell. E do ta mbushte tokën deri në qiell me aromë parfumi. Vetëm velloja që mban mbi kokë, vlen më shumë se e gjithë bota dhe çfarë ka në të]¹⁰⁵

PLAKAT RIKTHEHEN NË MOSHËN E DASHURISË..

Allahu thotë në Kuran:

(Ato janë bukuroshe me gjinj të ngritur dhe të gufuar), për këtë ajet Pejgamberi a.s tha: Kështu do të jenë ato gra që dolën nga kjo botë si plaka të thyera në moshë. Jetuan dhe vdiqën me Iman dhe me Islam. Këto në Xhenet do të ringjallen si virgjëresha bukuroshe. Me gjinj të ngritur dhe shumë të dashura. Janë kulmi i dashurisë. Dashuria me to simbolizohet. Të gjitha do të jenë në të njëjtën moshë.

Nëse ato do të jenë kaq të mrekullueshme, po gratë e kësaj bote që jetuan dhe vdiqën si besimtare? A thua do të jenë kaq bukuroshe sa këto?

Pejgamberi a.s e bën dallimin mes grave të Dynjasë dhe Hurive të Xhenetit. –Sigurisht, thotë Pejgamberi a.s. Ka dallim të madh mes tyre. Gratë e Dynjasë janë më të bukura se Huritë e Xhenetit. Dallimi mes tyre është si ana e mbarë dhe astari i një fustani. Sepse gratë e Dynjasë, përjetuan mundimet e kësaj bote. Ato falën Namazin, agjëruan, ishin adhuruese të mëdha. Përjetuan dhimbjet në këtë botë, dhimbjet e lindjes, sëmundjet, torturat dhe mundimet. Në këtë kohë ato nuk do të jenë njësoj. Allahu do tua ndriçojë fytyrën, do t`u dhurojë fustane mëndafshi. Do të kenë lëkurë të bardhë, rroba jeshile. Bizhuteri të verdha, gjerdanë me perla. Krëhërat e tyre janë të florinjte. Ato

¹⁰⁵ Hadith i saktë, e transmeton Buhariu me nr. 2643

këndojnë: *Ne jemi të përjetshmet që nuk vdesim. Ne jemi të ëmblat që nuk shëmtohem kurrë. Ne jemi bukuroshet që nuk veniten asnjëherë. Ne jemi të lumturat që nuk dëshpërohem asnjë herë. I bekuar është burri ynë për ne. E të bekuara jemi ne për të.*

SHETITJE

Një vizitë në pronën e një Xhenetliu. Futemi në pallatin e tij mbretëror. Të tilla Saraje do t'i kenë secili nga Xhenetlinjtë bashkë me mbretëreshat e tyre.

Gjithçka që u duhet aty do ta gjejnë. Gjithçka aty nuk sigurohet si nevojë, por merret si kënaqësi. Jeta e tyre supozohet në çift dhe familjet e tyre do të jenë po ashtu në çift. Ashtu si dikur ishte Ademi me Havanë, ashtu do të jetë secili banor i Xhenetit me gruan e tij. Një mbretëri e madhe për secilin. Aty do të bëhet edhe jetë sociale me të tjerë miq. Ata vizitojnë njëri tjetrin në mbretëritë e tyre. Do të jenë në dhoma të larta të dekoruara dhe plot dritë. Nga brenda shikohet gjithçka jashtë. Të tejdukshme dhe brilante. Në frone të lartë ulur me njëri tjetrin. Atmosferë e freskët, as vapë dhe as ftohtë. Errësira nuk ekziston. Nuk ekziston as mërzia.

A NUK DO TË VELITEMI NGA KJO KËNAQËSI?

Velitja në fakt është për shkak të shqisave tona të kufizuara. Ato sa janë në këtë botë, kanë një limit ku ngopen dhe stërmundohen përtej këtij limiti. Përshebull ushqimet më të mira, në këtë botë kanë një limit, pastaj trupi nuk i përballon më. Po ashtu edhe pijet, po ashtu edhe kënaqësitë trupore. Po ashtu edhe kurioziteti për të parë dhe dëgjuar. Të gjitha veliten, në këtë botë. Sepse edhe kjo botë është e vogël. Prandaj

edhe quhet Dunja. Dmth parametra të vegjël (e ulët, e poshtëme, jo e lartë) Ashtu si një pajisje kompjuteri e viteve 90-ta, ku nëse do të mbante 1 giga byte hapësirë, do të ishte më i miri. Mirpo sot teknologjia flet për miliona gigabyte. Atëherë nuk supozohej që në telefon të kishim mundësi të shikonim live ose ndiqnim një program live. Por sot kjo është lehtësisht e mundur. Sepse teknologjia ka arritur nivele të tjera të parametrave. Kjo botë në fakt nuk është për të realizuar kënaqësitë në të. Por për të testuar secilin prej nesh me larminë e skenave që ofrohen në të. Por në fund gjithçka që ofrohet në këtë botë janë të limituara, thjesht për test. Ofertat e vërteta do të jenë në Xhenet. Ashtu si shishet e vogla të testit për llojet e Parfumeve. Ato nuk janë vetë Parfumi.

Në Xhenet, ka të tjera nivele të parametrave. Edhe trupi dhe shqisat tona kanë të tjera nivele të parametrave. Duke qenë të përjetshëm, edhe trupi jonë përshtatet që të jetë i palimituar në parametra. I padëmtueshëm nga limitet kohore, madje në fakt, atje koha nuk do të ekzistojë.

(Atë ditë as toka nuk do të jetë kjo që është. Po ashtu edhe qiejt do të zëvendësohen..)¹⁰⁶

Nuk do të ekzistojnë vitet dhe as orët. Gjithçka do të jetë thjesht nocion orientimi, por jo edhe nocion konsumimi të vetes dhe gjithçkaje që na rrethon. Në këtë botë, gjithçka dhe çdo kënd, e konsumon koha. Por atje koha nuk mund ta konsumojë asgjë. Prandaj quhet Përjetësi. (el Khulud) Pa Kohë..

Vendosi disa ajete qe tregojne perjetesine e xhenetlinjeve..

¹⁰⁶ Kurani, Sure Ibrahim, Ajeti 48

(Shpërblimi i tyre është Falje prej Allahut dhe Xhenete, nën të cilat rrjedhin lumenj. Ata do të jenë aty përgjithmonë. Ky është shpërblim kaq i mirë, për ata që punojnë dhe mundohen)¹⁰⁷

(Ata që besuan dhe bënë vepra të mira, do ti fusim në Xhenete që nën to lumenj. Do të jenë përjetësisht aty. Do të kenë aty bashkëshorte të pastra. Do të jenë në hije pushimi të mrekullueshme)

(Ata të bekuarit do të jenë përjetësisht në Xhenete, sa të ketë qiej e tokë..)¹⁰⁸

Atje nuk ka mërzitje, sepse kënaqësitë do të jenë të vazhdueshme. Atje jetohet për tu kënaqur dhe jo për të mbijetuar. Atje kënaqësitë janë pa lodhje dhe pa venitje..

Nëse keni menduar se e dini çfarë është qefi, në Xhenet do tju ndryshojnë krejt këto parametra.

Qefi këtu është me dhimbje. Por atje dhimbja nuk ekziston. Dëshirat këtu janë të mëdha. Por nuk mund të realizohen të gjitha. Ato dëshira dhe shumë të tjera, realizohen vetëm nëse ke një mbretëri, të gjithën për vete.

Atje njeriu me gradën më të ulët në Xhenet, do të posedojë një mbretëri, që është dhjetë herë më e madhe dhe më e fuqishme, sesa mbretëria më e fortë e kësaj bote.

Në një mbretëri ku diamantet dhe Floriri nuk do të jenë më metale të rralla. Por do të jenë thjesht dekor në pallatet që posedon Xhenetliu.

¹⁰⁷ Kurani, Sure Al Imran, Ajeti 136

¹⁰⁸ Kurani, Sure Hud, Ajeti 108

(Ata që besuan dhe bënë vepra të mira, All-llahu do t'i vendosë në Xhennete, nëpër të cilin rrjedhin lumenj. Aty stolisen me rrath të artë e me smeralde. Ndërsa rrobat e tyre janë të mëndafshta.)¹⁰⁹

Aty kafshët do të jenë të gjitha llojet, nga më normalet e deri tek më ekzotiket. Por edhe shumë lloje të tjera, që kurrë nuk i kemi njohur. E të gjitha këto, do të jenë të padëmshme. Shpendët gjithashtu do të jenë shumëngjyrëshe, e shumë llojesh. Me zëra të bukur e me plot argëtim, për Xhenetlinjtë.

Ushqimi, aty do të jetë çdo gjë vetëm për të shijuar. Nuk do të ndjejmë uri, as velitje dhe as fryrje. Do të hamë çfarë të kemi qef, dhe asgjë nuk do të na bëjë pis.

Një tjetër përshkrim vjen nga Pejgamberi a.s: [...Në Xhenet nuk do të pështyhet dhe as do nxirren sekrecione, as jashtëqitje nuk do të ketë.

*Enët e tyre do të jenë prej Floriri. Do të kenë krëhëra prej floriri dhe argjendi. Kanë temjane prej Aloe me aromë Misku. Çdonjëri prej tyre do të ketë nga dy nuse (të kësaj bote) u duket palca e kërcirit në pulpat e këmbëve të tyre, prej bukurisë dhe dëlirësisë që kanë. Nuk do të kenë asnjëherë sherre mes tyre. Do të kenë të njëjtën zemër dhe mendim së bashku. Ata e madhërojnë Allahun në mëngjes dhe në mbrëmje]*¹¹⁰

Asgjë nuk do të na mërzitet dhe asgjë nuk do të na duket e papërshtatshme. Përgatitja është e menjëhershme, gjithçka që dëshiron të bëhet gati menjëherë. Shërbëtorët janë të zellshëm në servirje.

Në fund mbetjet nuk do ti shkarkojmë si në këtë botë. Ato do të dalin nga trupi jonë në formën e djersës, e cila në vetvete është një

¹⁰⁹ Kurani, Sure El Haxh, Ajeti 23

¹¹⁰ Hadith i saktë, i transmetuar nga Buhariu me numër. 3245

parfum i përhershëm i joni. Ajo do të ketë të gjitha aromat që dëshirojmë dhe sa do ti dëshirojmë.

Veshjet e banorëve të Xhenetit do të jetë me ngjyra të ndryshme. Por do të mbizotërojnë ngjyra e bardhë dhe ngjyra e blertë..

JETË SOCIALE..

Sigurisht, ne jemi mësuar që këtë botë ta kalojmë me shumë njerëz përreth. Për këtë arsye në Xhenet, jeta sociale do të jetë shumë herë më aktive, se në këtë botë. Do të shkojmë dhe vijmë në sarajet e njëri-tjetrit. Do të organizojmë festa në pallatet tona. Do të jemi të ulur në kolltuqe të qëndisur, në salla të mëdha ballosh. Muzika dhe atmosfera është argëtuese.

(U kemi hequr prej zemrave të tyre çfardo urrejtje dhe vesesh. Ata janë të ulur në mbështetëse duke qëndruar ballë për ballë njëri-tjetrit. Janë të vëllazëruar me njëri-tjetrin. Nuk do të lodhen kurrë dhe nuk do të dalin prej aty asnjëherë)¹¹¹

PAZARI I XHENETIT..

Në Xhenet ka edhe qendra tregtare për shopping. Shopping thjesht për qef. Thjesht për tu argëtuar. Për të plotësuar kështu edhe një pikë të dobët që e kanë gratë. Aty blihet dhe shitet çdo gjë. Serviret moda e fundit, dhe mjetet më të fundit

Atje do të njihen të gjitha dimensionet e hapësirës, do të njihen anët: Veri, Jug, Lindje, Perëndim.. Pejgamberi a.s thotë: *[Në Xhenet ka një treg të madh. Aty shkojnë çdo ditë Xhumaje. Pastaj fryn era e veriut*

¹¹¹ Kurani, Sure El Hixhr, Ajetet 47-48

që ua ledhaton fytyrat dhe rrobat e tyre. Ajo ua shton edhe më shumë bukurinë. E kur kthehen në shtëpinë e tyre, nuset e tyre u thonë se janë bërë edhe më të bukur. Ata thonë: Pasha Zotin edhe ju jeni bërë më të bukura, sesa ishit kur dolëm nga shtëpia.

DËSHIRA TË VEÇANTA..

Ka shumë njerëz, që disa ndjenja nuk kanë arritur t'i provojnë në këtë botë. Në Xhenet, do t'i provojnë ato, madje me kënaqësi shumë herë më të mëdha.

Do të provojnë dashurinë e parë që nuk mundën ta provonin në këtë botë. Ose thjesht nuk arritën ta realizonin. Atje me nuset e tyre, do të përjetojnë dashuri të zjarra shumë herë më të mëdha se ato të dashurisë së parë në këtë botë.

Do të ketë edhe prej tyre që në këtë botë nuk patën fëmijë. Amësia dhe Atësia, janë ndjenja të veçanta për shpirtin e njeriut. Atje nëse mbreti dhe mbretëresha e tij duan një fëmijë, do ta lindin atë së bashku, por jo me nëntë muaj lodhje, as me dhimbjet e lindjes. Shtatëzania atje do të përfshijë të gjitha dashuritë e Amësisë. Do të përfshijë gjithashtu edhe afrimitetin e atësisë. Pastaj bebi që do të lindë, do të ketë të gjithë ëmbëlsinë e bijve dhe bijave, por kësaj rradhe shumë herë më shumë. Aty do ta zgjedhësh vetë gjininë e bebit tënd. Do ta zgjedhësh edhe ngjyrën e syve. Aty nuk do të preokupohesh për qarjet e bebit natën. Nuk do të sëmuret asnjëherë. Do ta ushqesh me gjirin tënd, ashtu si çdo grua ëndërron. Pastaj do të rritet e nuk do kesh problem edukimin e tij dhe as shkollimin. Ai rritet në mënyrë perfekte. Do ta shohësh birin tënd të rritet para syve të tu, në një kohë ndoshta më të shpejtë se rritja normale. Pastaj do ta shohësh kur të vazhdojë jetën e tij. Pafundësi

kohore dhe pafundësi hapësinore.¹¹² Gjithçka krijohet aty për aty. Gjithçka funksionon dhe asgjë nuk prishet.

Do të ketë edhe prej atyre që kanë qef të kenë pronat e veta dhe do t'i mbjellin sipas dëshirës që duan. Por nuk do të vuajnë thatësirën dhe as lodhjen e punimit të tokës. Do të mbjellin bimët që duan dhe do të marrin prodhimet që kanë qef. Sa, dhe si t'i duan. Gjithçka e realizuar menjëherë. Atje nuk funksionon si këtu me ligjet e fizikës. Nuk ka nevojë të vijnë reshjet, për ta vaditur dhe as të vijnë koha e të korrave, për të mbledhur prodhimin. Atje ato bëhen menjëherë.¹¹³

Imagjinoni, toka nuk do të jetë si kjo e jona dhe as qielli nuk do të jetë i njëjtë.

(..Ditën kur toka ndryshohet në tjetër tokë, e edhe qiejt (në tjerë qiej))¹¹⁴

Disa të tjerë kanë qef aventurat, lumenjtë që rrjedhin, notin në det, fluturimin në ajër gjuetinë dhe shumë sporte të tjera.

Të gjitha këto do të kenë kompeticionet e veta. Secili do marrë pjesë diku privatisht, diku bashkarisht me miqtë e vet. Mjetet që ne i njohim sot, aeroplanët, anijet, makinat, para qindra vjetësh do të ishin të paimagjinueshme. Por sot janë mëse normale. Ndërkohë që në Xhenet, është krejt tjetër gjë. Çfarë kemi sot në këtë botë, do të dukeshin rrangalla të padobishme, me ato që do të kemi në Xhenet. Ashtu si një qerre me buaj, nuk është më e dobishme në ditët tona.

Allahu thotë në Kuran:

¹¹² Bazuar në Hadithin e Saktë të transmetuar nga Tirmidhiu me nr. 2563.

¹¹³ Bazuar në Hadithin e Saktë të transmetuar nga Buhariu me nr. 7081.

¹¹⁴ Kurani, Sure Ibrahim, Ajeti 48

(Aty do të ketë gjithçka që shpirti ta don dhe sytë ta pëlqejnë)¹¹⁵

(Ata që besuan dhe bënë vepra të mira, do të jenë në Kopshtet e Xheneteve. Do të kenë aty, gjithçka duan prej Zotit të tyre. Ajo është mirësi e madhe)¹¹⁶

HISTORIA

Një pjesë interesante në Xhenet do të jetë edhe historia.

Atje Historia do të përjetohet LIVE në të gjitha dimensionet e përjetimit. Pra jo thjesht vetëm dimensionet 3D. Por do të kemi mundësi të hyjmë brenda atyre ngjarjeve, të bëhemi edhe aktorë në atë histori. Të gjendemi përballë sfidave që ndodhen në ato histori. Por me një ndryshim, atje brenda në ato luftime dhe përballje nuk dëmtohesh.

Shumë prej nesh do të dëshironin të përjetonin Live të gjithë historinë e tyre në këtë botë. Kohën e fëmijërisë dhe kohën e rinisë dhe pleqërisë. Momentet më të bukura të jetës, momentet më të dashura për të. Disa do të donin të përrjetonin Live, pjesë të ndryshme në Histori. Dikush do të donte të përjetonte LIVE historinë e Pejgamberit Muhamed a.s, apo të pejgamberëve të tjerë. Dikush do donte të ishte aktor në betejën e Bedrit, apo Uhudit. Dikush do të donte të ishte në Pallatin e Sulejmanit a.s. Dikush do donte të përjetonte luftërat botërore, etj. Të gjitha këto mund të arrihen aty live dhe ti të jesh aktor në ato ngjarje. Atje nuk ka diçka që quhet e kaluar dhe e ardhme. Atje çdo pjesë e kaluar mund të kthehet dhe ripërseritet, sepse koha ka pushuar së ekzistuari. Kur themi Përjetësi, dmth nuk ka të shkuar dhe nuk ka të ardhme. Por ka vetëm të tashme.

¹¹⁵ Kurani, Sure El Zukhruf, Ajeti 71

¹¹⁶ Kurani, Sure El Shura, Ajeti 22

DASHURIA..

Përtej erotikës dhe fantazisë së sëmure të kësaj bote.. Në Xhenet bëhet dashuri njësoj si në këtë botë. Mirpo femra dhe mashkulli nuk do t'i kenë problemet që kanë në këtë botë. Femra nuk do të ketë menstruacione dhe as vuajtje prej tyre. Ndërsa mashkulli nuk do të ketë probleme mashkullore. Nuk do të lodhen dhe as mërzhiten. Të gjitha tërheqjet femërore dhe mashkullore atje funksionojnë shumë herë më mirë se në këtë botë. Por sigurisht të gjitha ndyrësitë e kësaj bote atje do të jenë bërë DELETE. Dmth do të jenë fshirë të gjitha tërheqjet jashtmartesore. Do të jenë fshirë të gjitha tërheqjet e së njëjtës gjini.

Atje do të jetë gjithçka e pastër, e dlië, e fuqishme, shumë pasionante dhe tepër e kënaqshme. Të gjitha vetëm për tu shijuar dhe asgjë e papastër. Femra atje do të jetë përherë e virgjër, ashtu si mashkulli e dëshiron. Pastaj sa herë mbarojnë dashurinë e tyre, femra do të rikthehet në virgjërinë e saj dhe dëlirësinë e saj. Ashtu si ajo përherë dëshiron. Sigurisht marrja e virgjërisë nuk do të jetë dhimbje dhe frikë për femrën në Xhenet. Ajo do të jetë një kënaqësi që ia dhuron burrit të saj, dashurisë së saj të parë dhe të vetme. Ashtu ajo do të plotësojë këngën e saj, “Unë jam e jotja dhe vetëm e jotja”

LUMENJTË DHE LIQENET..

Ndryshe nga sa jemi mësuar në këtë botë, në disa vende, lumenjtë do të rrjedhin nën tabanin e dhomave të pallatit mbretëror. Aty rrjedhin lumenj qumështi dhe lumenj mjalti. Rrjedhin edhe lumenj vere, e lumenj pijesh të tjera, që në këtë botë na ishin të ndaluara, sepse na dëmtonin.

Në Xhenet do të ketë Verë. Por edhe shumë pije të tjera të njohura dhe të panjohura për ne. Ato nuk do të jenë më dehëse dhe as turbulluese. Por do të kenë shijen origjinale dhe më cilësore të pijes, pa efektin dehës dhe turbullues. Aty nuk ka diçka që quhet Haram. Gjithçka që sheh përqark është hallall.

(Shembulli i Xhennetit, që u është premtuar besimtarëve. Në të, gjenden lumenj me ujë të kthjellët; lumenj të qumështit me shije të pandryshuar; lumenj të verës me shije të këndshme, për ata që e pijnë. Do të ketë lumenj prej mjaltit të kulluar. Aty kanë edhe lloj-lloj pemësh dhe falje (të mëkateve) prej Zotit të tyre..)¹¹⁷

Nga lumenjtë që rrjedhin poshtë këmbëve të tua, do të kesh mundësi të zgjatësh dorën e të mbushësh një kupë me lëngun që rrjedh aty. Me qumësht, verë, mjaltë, madje edhe me kapuçino, nëse ke qef. Kamariertë janë gati për të të shërbyer ty, pa përtim.

(Atyre u shërbejnë aty, djelmosha të përhershëm si shërbëtorë. Do tu shërbejnë me kupa, me ibrikë dhe me lëngje prej pijesh nga burimi. Pije që nuk do të kenë dhimbje koke dhe nuk do të jenë dehëse. Gjithashtu u shërbejnë me fruta sipas dëshirës e mish zogu të zgjedhur..)¹¹⁸

Të sjellin gota kristali të mbushura me pije, miksuar me zenzhebil. Ata e mbushin me delikatesën më të madhe në sasinë që dëshiron.

Por aty ka dhe një pije të zgjedhur. Është pija e butë që rrjedh nga lumi SELSEBIL¹¹⁹

¹¹⁷ Kurani, Sure Muhamed, Ajeti 15

¹¹⁸ Kurani, Sure el Vakia, Ajetet 17-21

¹¹⁹ Emër i një lumi të Xhennetit që dmth tepër i rrjedhshëm dhe i lehtë..

E ka marrë këtë emër për shkak të dendësisë së ujit që është shumë e pakët dhe uji është shumë i lehtë. Allahu e ka përzgjedhur shijen e tij, për miqtë e Vet, që janë banorët e Xhenetit. Selsebil, është një pije që ta kënaq gurmazin dhe rrjedh lehtë mbi të. Me të do të bëhen edhe pijet me aromë trëndafilash. Bashkuar me lehtësinë dhe rrëshqitshmërinë e tij në gojë, bashkë me aromën e trëndafilave, kemi të bëjmë me një pije të përkryer. Zoti atyre u jep të pijnë vetëm pije të pastra.

Kudo që hedh shikimin, shikon që ke të bësh me një Mirqenie dhe Luks madhështor.

(Për durimin që bënë, Allahu i shpërbleu me Xhenete dhe petka mëndafshi. Ata qëndrojnë të mbështetur në fronë e nuk i djeg as dielli e nuk i mundon as i ftohti. Hijet e pemëve i kanë afër, dhe frutat e tyre arrijnë me dorë. Atyre u shërbehet me enë prej argjendi dhe gota kristalesh të tejdukshëm. Në enë argjendi të tejdukshme gjithashtu. Gota të përshtatëshme sipas pijes që u serviret. U serviren pije aromatike me Zenxhebil. Dhe ujë të lehte, nga Burimi që quajtur Selsebil. U shërbejnë atyre djelmosha shërbëtorë të përhershëm (krijuar enkas për shërbim) si margaritarë.

Gjithçka të kap syri aty, është begati e mrekullueshme dhe Pasuri të mëdha..)¹²⁰

RROBAT E XHENETLINJVE.

Siç thamë më lart rrobat do të jenë modele të ndryshme sipas kënaqësisë dhe shijeve. Por ndër rrobat më të bukura që do të përdorin janë pelerina të mëndafshita tepër të buta që quhen Sundus. Ka prej tyre

¹²⁰ Kurani, Sure El Insan, Ajetet 12-20

që janë të trasha dhe të gufueshme. Ka të tjera që janë të holla e të lehta. Në duar mbajnë byzylykë argjendi.

(Xhenetlinjtë janë të veshur me rroba mëndafshi të hollë e të gjelbër (atllas) ose mëndafsh të trashë (brokat). Ata janë të stoliur me bylyzykë të argjendtë. Zoti i tyre u jep të pijnë ujë të pastër. E gjithë kjo është shpërblimi juaj, sepse jemi Mirnjohës për mundimin dhe sakrificat tuaja.)¹²¹

Banorët e Xhenetit janë rehatuar në Xhenet, banorët e Xhehenemit janë burgosur në Xhehenem. Allahu i Madhëruar i ka dhuruar Xhenetlinjve gjëra që ata nuk i kishin imagjinuar ndonjëherë.

Madje edhe ky shkrim, është një orvatje e varfër, për të konceptuar ato çfarë xhenetlinjtë do të kenë. Në fakt, ne kemi folur për gradat e ulta të Xhenetit. Jo për ato më të larta. Arsyeja është e thjeshtë. Imagjinata jonë nuk mund të arrijë aq larg. Askush nuk mund të imagjinojë çfarë ka përgatitur Allahu, për Xhenetlinjtë në gradat e larta.

Musai a.s e ka pyetur Allahun e Madhëruar: O Allah, çfarë të mirash ke përgatitur për ata që kanë gradat më të larta në Xhenet? Allahu i madhëruar i përgjigjet: Shpërblimin e tyre në Xhenet e kam mbjellë me Dorën Time. Atë e kam mbyllur dhe do të jetë surprizë për ta. Askush nuk ka dëgjuar dhe as ka parë madje as ka imagjinuar se çfarë do të jetë ajo.

Xheneti rigjenerohet vazhdimisht me bukuri të reja. Edhe Xhehenemi po ashtu rigjenerohet vazhdimisht me tortura të reja.

¹²¹ Kurani, Sure El Insan, Ajetet 12-22

DISA KUJTIME TË VËSHTIRA..

Disa shokë me njëri-tjetrin, aty në Xhenet, bisedojnë. Kujtojnë jetën dhe vuajtjet që kanë kaluar në këtë botë.

- Hë thotë njëri, a të kujtohet sa shumë kemi vuajtur në dynja. Sesi faleshim fshehurazi. Sesi vija unë tek ti dhe ti tek unë dhe të zgjoja për syfyr? E mban mend kur i shkruanim me dorë oraret e Namazeve dhe oraret e Agjërimit? Sepse i kishim spiunat gati për të na arrestuar.

Disa të tjerë thonë:

-Eh unë nuk qëndrova në heshtje, kur pashë se ata po e mohonin Zotin, por ngrita zërin. Derisa më arrestuan dhe pastaj më vranë, sepse thashë: Zoti jonë është vetëm Allahu!

Pastaj disa të tjerë duke qeshur do thonë:

(E nisin bisedojnë me njëri-tjetrin. Thotë njëri: Kam patur dikur një shok, që më thoshte: Ti vërtetë beson se pasi të kemi vdekur dhe të jemi bërë eshtra, do të ringjallemi për tu gjykuar? Pastaj i thotë shokëve të vet: A po e shihni atë, ku është tani? Ata zgjaten dhe e shikojnë atë në mes të Xhehenemit. Pastaj thotë: Pasha Zotin, për pak sa nuk më more dhe mua me vete aty. Po të mos ishte dhurata e Allahut për mua, tani do isha aty me ty. Tashmë nuk ka më vdekje. Ishte vetëm ajo vdekja jonë e parë. As nuk do të vuajmë më. Kjo është fitorja jonë e madhe)¹²²

NJERIU I FUNDIT NË XHENET..

¹²² Kurani, Sure Es Safatë, Ajetet 50-60

Pas tij nuk do të hyjë më, askush në Xhenet. Ai ka kaluar periudhën më të gjatë në Xhehenem. Nuk bëhet fjalë për vite, as për dekada. Por bëhet fjalë për epoka, që ai i ka kaluar në Xhehenem.

Pasi Allahu jep urdhër që të nxirren të gjithë ata që kanë patur një grimcë Besim në zemër. Engjëjt i kanë nxjerrë shumë prej atyre, që kishin në zemër, qoftë edhe pak besim në Allahun xh.sh.

Kanë pas pirë alkol, kanë pas bërë imoralitet, kanë pas qenë neglizhentë ndaj namazeve. Disa madje kanë pas vrarë edhe njerëz; disa të tjerë kanë qenë tradhëtarë dhe të poshtër. Por në fakt, një grimcë të vogël besimi, ata e kanë patur në zemër.

Pasi mbarojnë dënimet e tyre në Xhehenem, Allahu i urdhëron engjëjt që t'i nxjerrin nga Xhehenemi dhe disa trupa të djegur dalin nga liqeni i llavës.

Ata merren dhe sillen pranë portave të Xhenetit. Aty u derdhet mbi ta, uji i jetës dhe trupat u fillojnë të marrin jetë. Kanë shpëtuar nga më e keqja. Tashmë më e mira vjen. Tashmë edhe për ta kanë ardhur ditët e mira. Qelizat e trupit të tyre po rigjenerohen. Nga disa trupa të djegur deri në palcë, ata tashmë po formësohen. Po u kthehen gjymtyrët, po i kthehet koka dhe krejt pjesët e tjera të trupit. Tashmë janë gati të futen në Xhenet. Më në fund edhe atyre po u hapen portat e mëdha të Xhenetit. Ai besim i vogël që e kishin diku thellë në zemër, sot u ka bërë dobi. Atëherë në Dynja, patën thënë: Ka Zot. Por pastaj e kishin harruar Zotin. Ama ajo fjalë, ajo dëshmi, ishte regjistruar dhe sot po u del përpara.

Futen dhe këta mjeranët në Xhenet. E çfarë të shohin aty? U ngjan vetja të huaj dhe se nuk janë të kësaj bote. Shohin të gjithë njerëzit të sistemuar në vendet e veta. Aq sa mendojnë se për ata nuk ka mbetur asgjë. Por menjëherë engjëjt, i përshëndesin me Selam. Ku kanë

provuar ndonjëherë këta mjeranë ti trajtojë dikush me kaq butësi dhe respekt? Ata kanë parë vetëm Zebanije me sy.

Pastaj atyre u vjen një Engjëll dhe i thotë: Pasi erdhët këtu, për ju nuk ka më dëshpërim, nuk ka më vuajtje.

Ata nisin të qajnë nga gëzimi. Janë munduar shumë prandaj. Pastaj daroviten me ujin që shuan etjen përgjithmonë. Ujin e Keutherit. Pijnë prej tij e ngopen.

Mirpo edhe një problem e kanë. Në ballë u ka mbetur akoma një shenjë e djegur, pasojë e qëndrimit në Xhehenem. Edhe pse ajo nuk dhemb, sepse në Xhenet nuk ka vuajtje dhe dhimbje. Por atyre ajo u ngjan e turpshme para banorëve të tjerë të Xhenetit. Andaj e lusin Allahun që edhe atë shenjë në ballë tua fshijë. Kështu edhe ndodh. Gjithçka që Xhenetliu dëshiron, plotësohet menjëherë.

Tashmë atyre u caktohen vendet e tyre në Xhenet. Engjëjt i bashkojnë me familjarët e tyre Xhenetlinj. Prindërit do të takohen me fëmijët e tyre, bashkëshortët me njëri tjetrin, miqtë dhe shokët po ashtu do të takohen. Vëllezërit dhe motrat po ashtu. Ata Xhenetlinjtë e mëparshëm kanë dalë në fakt ti presin. Allahu i ka njoftuar se do të vijnë njerëzit e tyre të dashur. Pasi më parë ua pati hequr dashurinë për ta, tashmë ua ka rikthyer përsëri dashurinë për këta mjeranë, që sapo kanë shpëtuar nga Xhehenemi. Takohen me njëri-tjetrin me shumë mall. Pastaj Allahu u jep leje që edhe këta mjeranë të bashkohen me njerëzit e tyre xhenetlinj.

Dhe ja si e përshkruan Pejgamberi a.s këtë ngjarje të madhe..

[Banorët e Xhenetit do t'i luten Allahut duke i thënë: O Allahu ynë! Kemi patur disa shokë e miq, që faleshin me ne, agjëronin me ne, bëmë Haxhin bashkë. Por Ti i ke futur në zjarr. A don t'i nxjerrësh ata për ne?]

Allahu u thotë: Shkoni dhe nxirrni të gjithë ata që i njihni.

Kështu ata shkojnë dhe nisin t'i dallojnë ata sipas pamjeve të tyre. Sepse zjarri nuk ua ka prishur pamjet identifikuese. Do të ketë prej tyre që zjarri i ka shkrumbuar deri në nyjet e këmbëve të tyre. Disa të tjerë zjarri i ka shkatërruar deri në gjunjë. I nxjerrin nga Xhehenemi dhe e falenderojnë Allahun që i nxorrën.

Pastaj Allahu thotë: Nxirrni nga zjarri, të gjithë ata që besimi i tyre u peshonte sa një monedhë dinari. Pastaj përsëri thotë: Nxirrni të gjithë ata që kanë patur në zemër edhe sa gjysëm monedhe dinari. Pastaj Allahu i madhëruar thotë: Nxirrini edhe ata që kanë patur edhe sa një grimcë Atomi besim në zemrën e tyre.

Pasi dalin nga zjarri, Engjëjt thonë: O Allahu ynë! Nxorrëm nga zjarri, të gjithë ata që na urdhërove. Tani nuk ka mbetur në zjarr, askush që ka patur ndonjë mirësi në vete.

Pastaj Allahu thotë: I lejova Engjëjt të ndërmjetësojnë; i lejova Pejgamberët të ndërmjetësojnë; lejova edhe besimtarët të ndërmjetësojnë. Tani jam Unë Mëshiruesi i Mëshiruesve për të bërë atë që duhet.

Allahu merr një grumbull, ose dy grumbuj prej xhehenemlinjve, që nuk kanë bërë asnjë të mirë asnjëherë. Janë djegur aq sa janë bërë prush.

Pastaj merren të gjithë dhe dërgohen në një vend që quhet Uji i Jetës. Dhe u hidhet ky ujë përsipër. E ata nisin të çelin jetë, ashtu si bima që çel në bregun e një përroi.

Ata dalin nga trupat e tyre të djegur si të ishin diamante. Ndërsa në qafë kanë të varur vulën “Të amnistuarit e Allahut”

U thuhet atyre: Hyni në Xhenete. Gjithçka që dëshironi dhe gjithçka që ua sheh syri është e juaja, dhe keni edhe një tjetër Dhuratë më të mirë prej Meje. “Të amnistuarit prej gëzimit thonë: E çfarë më shumë o Allahu ynë, o i Dashuri ynë?.. Allahu u thotë? Unë do të jem i kënaqur me ju dhe kurrë nuk do të mërzitem prej jush.]¹²³

ËSHTË DHE DIKUSH ATJE..

Atje në fund, diku në një nga humnerat e Xhehenemit, ka mbetur dhe dikush tjetër, nga këta mjeranë. Dikënd që engjëjt nuk e kishin shënuar në regjistrin e të shpëtuarve.

Ai, sa ishte në këtë botë, dikur kish thënë: Po sikur vërtetë të ketë Zot? Pastaj e kishte harruar fare këtë punë. Mirpo Allahu nuk harron. Allahu nuk lejon të humbë asgjë e mirë që njeriu ka bërë në këtë botë testuese. Ky mjeran, do të jetë edhe njeriu i fundit që do të dalë nga Xhehenemi. Pas këtij, të gjithë të tjerët do të mbesin aty përgjithmonë dhe shpresa më nuk ka se do të dalë kush tjetër.

Duke u përpëlitur nëpër dallgët e tmerrshme të llavës, duke u torturuar e përpjekur nga Zebanijet e Xhehenemit, më në fund diçka ndodh me të. Atij i tregohet një shkëmb diku si breg, të cilën ai niset për ta arritur. Dëshiron të pushojë pak nga torturat që po vuan. Kur arrin aty, Allahu i mundëson të shikojë një vend tjetër më të lartë në Xhehenem ku do të ndjehet më i i sigurtë nga tmerri që ka përjetuar. E lut Allahun! O Allah më dërgo në atë vend të pushoj pak se jam munduar shumë. Allahu i madhëruar i flet: O robi Im, do të ta jap këtë mundësi, por dua që pas kësaj të mos më lutesh më për asgjë. -Dakord, thotë mjerani, nuk do të të lutem më për asgjë. Pastaj Allahu e dërgon këtë të qyqar, në atë shkëmb të mbrojtur nga tortura. Mirpo aty në atë shkëmb, Allahu ia

¹²³ Hadith i Saktë i transmetuar nga Muslimi, me nr. 2829

tregon bregun e Xhehenemit, nga ku flakët dhe tmerri nuk depërton. Andaj e lut përsëri Zotin: O Allahu im, më dërgo të lutem në atë vend të mbrojtur atje tej, e nuk të lutem më pas kësaj. Allahu qesh me robin e Vet dhe i thotë: A nuk më premtove o robi Im se nuk do të më kërkosh asgjë tjetër veç kësaj? –Të lutem Allah, ma plotëso dhe këtë lutje dhe nuk të kërkoj më asgjë, thotë qyqari. Allahu ia plotëson edhe kësaj rradhe. E dërgon atje në bregun e Xhehenemit. Mirpo aty duket Porta e madhe e Xhenetit. Prej atje tek fryn një erë e mirë e freskët, diçka që ky e thith vazhdimisht e mezi ngopet. Aty edhe trupi nis t' i gjenerohet pak nga pak. Kur arrin aty në atë vend, ai përsëri e ngre kokën lart dhe i lutet Allahut: O Allah të lutem më dërgo pranë portës së Xhenetit? Allahu qesh përsëri me robin e Vet dhe i thotë: A nuk më premtove se nuk do të më kërkosh asgjë tjetër? –Të lutem o Allah! Më ler të qëndroj aty të nuhas pak Aromë Xheneti, asgjë tjetër nuk të kërkoj më. Aman të lutem! Allahu përsëri i thotë: Dakord, do të ta pranoj edhe kësaj rradhe lutjen. Por dua të mos më kërkosh më asgjë tjetër. Dakord, thotë i mjeri njeri. Me vrap dhe me shumë dëshirë shkon në portën e Xhenetit. Kur arrin aty, çfarë të shikojë? Mrekulli që ky i shkreti ka kohë që i kishte harruar. Nuk mban mend kur ka qenë kënaqësia e fundit që ka provuar. Atje shikon gjallëri, njerëz që bëjnë jetë dhe kënaqen. Lakmon i ziu përsëri të ketë jetën e tyre. Por befas një trishtim i vjen. Tashmë aty brenda të gjithë i kanë zënë vendet e tyre. Nuk ka më vend për të. E me sy lakmues dhe shumë të përvuajtur kthen kokën lart dhe i lutet Zotit dhe një herë: O Allah, të lutem më fut brenda në Xhenet. Allahu përsëri qesh me të dhe i thotë: Por, a nuk më premtove se nuk do të më lutesh më? –Të premtova o Allah. Por të lutem, aman edhe këtë lutje të fundit ma plotëso! Dakord i thotë Allahu, do të ta plotësoj edhe këtë lutje. Kështu porta e Xhenetit hapet për herë të fundit, për të mos u hapur më kurrë pas saj.

Aty hyn një mjeran që i ka shpëtuar më në fund tmerrit të Xhehenemit. Pas tij nuk hyn kush tjetër në Xhenet. Habitët e shkreti nga

ajo që i shohin sytë dhe sesi e mirpresin Engjëjt e Xhenetit. Eja o i dashur. Eja o i mëshiruar. Eja o i pastruar. Eja o i nderuar. Erdhi dhe për ty dita të gëzohesh.

Sapo hyn në Xhenet, edhe Allahu tashmë flet me robin e Tij, jo me të njëjtën gjuhë, që i fliste pak më parë, duke ia kufizuar lutjet. Përkundrazi. Tashmë i thotë: O rob i Im lutu dhe Unë do ta jap. Fillimisht, rob i lutet për një vend në gjithë atë Xhenet të madh. Dhe atij i jepet vendi i vet në Mbretërinë e madhe të Zotit. Ai do të marrë gradën e fundit në Xhenet.

Për ty, thotë Allahu, kam përgatitur një mbretëri, që është dhjetë herë më e madhe se mbretëria e mbretit më të fuqishëm në Dynja. A je i kënaqur me këtë? Robi i shkretë thotë vetëm: Po, o Zoti im, kënaqësia dhe lumturia vetëm prej Teje vijnë. -Lutmu pra është koha të lutesh shumë, që të të dhuroj. Ato të gjitha që do të lutesh, Unë do të të jap dhjetë herë më shumë se kërkoje. Kështu rob i lutet, e lutet e lutet, derisa më në fund imagjinata shtron. Nuk di më, për çfarë të lutet më shumë. Atëherë, Allahu i sugjeron robit të Vet. Po këtë, a e don? Po këtë, këtë, atë, atë tjetrën? Gjëra që nuk janë në imagjinatën e tij fare. Pastaj ndodh më e madhja dhuratë..¹²⁴E gjithë sa thamë më lart në këtë paragraf, është bazuar në këtë hadith shumë interesant nga Pejgamberi a.s, i cili na jep disa detaje të habitshme, por edhe disa transmetime të tjera të Pejgamberit a.s dhe ato të sakta gjithashtu¹²⁵

¹²⁴ Historia e përshkruar me fjalët e mia, është e bazuar në disa Hadithe të Saktë të Pejgamberit a.s transmetuar tek Buhariu dhe tek Muslimi.

¹²⁵ [I fundit që do të hyjë në Xhenet është një njeri që ia nis duke dalë, nga Xhehenemi, Duke u rrëzuar e duke u ngritur përsëri e duke u rrëzuar, e zjarri duke e pllakosur fytyrës.

Por kur e kapërcen atë dhe del në breg, kthehet nga zjarri dhe i thotë: Zotit Faleminderit, që më shpëtoi prej teje..Me kaq sa më ka dhënë Allahu, askujt nuk i ka dhënë kaq shumë.

Aty, atij i paraqitet një pemë. Dhe ai thotë: O Allahu im, më afro në këtë pemë, që të freskohem pak nën hijen e saj. E të pij nga lëngu i saj. Por Allahu i madhëruar i thotë: O bir i

HAPET PËRDJA E ALLAHUT..

Një herë në javë, çdo ditë të xhuma, banorët e xhenetit thirren për të marrë dhuratën më të madhe që ekziston. Pas asaj dhurate edhe Xheneti rifreskohet me bukuri të tjera. Të gjithë mblidhen. Të gjithë ngrejne sytë në qiell. Ndodh ajo që shumë njerëz pyesin në këtë dynja: Kush e ka parë Zotin? E pra sot është koha që të hapet perdja e Allahut dhe xhenetlinjtë të shohin ALLAHUN E MADHËRUAR. –Do ta shikoni Zotin tuaj në Xhenet, aq qartë sa shikoni edhe hënën e plotë, ka thënë Pejgamberi a.s.¹²⁶

Është momenti më i madh është dhurata më e madhe për Xhenetlinjtë. Aty kanë çdo gjë, por kënaqësia e vërtetë është atë ditë, atë moment kur shohin Allahun e Madhëruar. Pavarësisht se kanë parë mrekulli të mëdha, nëse xhenetlinjve u thuhet a e don edhe këtë, secili do të thotë: PO e dua! Sepse Lakmia e njeriut është shumë e madhe. Është aq e madhe sa edhe në Xhenet vazhdon të kërkojë e të mbushet.

E megjithatë edhe lakmisë së njeriut i vjen fundi. Aty ku kupa nuk mban më është momenti kur shohin FYTYRËN E ALLAHUT TË MADHËRUAR..

Aty çdo lakmi, çdo kënaqësi, çdo përjetim, çdo ëmbëlsi ngopet. Shqisat plotësojnë çdo nevojë për të perceptuar. E megjithatë dhurata është aq e madhe sa i kalon të gjitha dhuratat që kanë patur deri tani..

Ademit! Nëse ta jap atë që ti kërkon, nuk dua të më kërkosh gjë tjetër. Ai thotë: Jo o Zoti im, nuk të kërkoj më asgjë tjetër. Dhe për këtë i jep fjalën se nuk do të kërkojë më asgjë. E Allahu e mëshiron. Sepse e di se mezi po pret të afrohet në hijen e asaj peme. Dhe e afron në atë pemë dhe freskohet në hijen e saj, e pin nga uji i saj. ..Vazhdon..

¹²⁶ Bazuar në Hadithin tek Buhariu me nr. 529

(Atë dotë do të ketë fytyra të shkëqyera, që po shikojnë tek Zoti i vet)¹²⁷

(Për ata që bënë mirë, Mirësi do të ketë. Madje dhe Shtesë. Fytyrat e tyre nuk do ti kaplojë zymtësia, dhe as poshtërimi. Janë ata, banorët e Xhenetit. Ata janë aty përgjithmonë)¹²⁸

Pastaj kthehen të ekzaltuar nga ajo kënaqësi e madhe që kanë përjetuar. E kur kthehen, gjithçka është rinovuar, gjithçka është më e bukur se më parë.

ALLAH I MADHËRUAR NA E MUNDËSO TË SHOHIM FYTYRËN TËNDE MADHËSHTORE.. AMIN..

Falenderimi i takon Allahut që më frymëzoi ta shkruaj këtë libër me shumë dashuri për Allahun e Madhëruar.

¹²⁷ Kurani, Sure El Kijame, Ajetet 22-23

¹²⁸ Kurani, Sure Junus, Ajeti 26

Radijtu Bilahi Rabben
Ve bil Islami Dinen
Ve bi Muhamedin, Nebijen ve Resulen

Allah i Madhëruar !

Na e prano këtë punë modeste. Bëje atë udhëzim për zemrat që të duan, por që akoma nuk të njohin Ty.

Bëje këtë punë, dritë për varrin tim dhe të gjithë atyre që kontribuan në këtë punë. Dhe familjarëve tanë.

Bëje këtë punë o Allah, ndërmjetësim dhe shkak për të fituar Mëshirën Tënde dhe Kënaqësinë Tënde..

Sepse kjo punë ka si qëllim vetëm Dashurinë Tënde..

Autori: Eduart Thartori